



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë Kontabilitet”

ofruar nga

Kolegji Universitar “LOGOS”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof.Dr.Drini SALKO

Prof.Dr.Dorina KRIPA

Shkurt / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Financë Kontabilitet"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "LOGOS"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Financë Kontabilitet
4	Urdhëri/VKM i licensimit:	UMASH Nr.1, Datë 06.01.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.16, Datë 01.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr.71, Datë 04.10.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhe Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 14 PAE / 9 PAK 2022-2023 13 PAE / 10 PAK 2023-2024 13 PAE / 12 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 12 studentë 2020-2021 12 studentë 2021-2022 11 studentë 2022-2023 9 studentë 2023-2024 7 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "LOGOS" (KUL) është një institucion privat i arsimit të lartë jofitimprurës, i licencuar me VKM nr.1055 date 29.07.2009. KUL i është akorduar akreditimi institucional me Vendim Nr. 58, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 15.12.2025. KUL sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij tre fakultete emërtuar si vijon:

- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
- Fakulteti Shkencave Humane dhe Komunikim Gjuhësor

Fakulteti Ekonomik ka në përbërjen e tij tre departamente:

Departamentin e Financë Kontabilitetit;

Departamentin e Menaxhimit;

Departamentin e Agrobiznesit;

Fakulteti Ekonomik (FE) dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit janë përkatësisht njësia kryesore dhe ajo bazë e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë Kontabilitet. Ky program studimi është hapur bazuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr.1, datë 06.01.2011 me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje tre vite akademike që përfshin 180 kredite dhe që zhvillohet në gjuhën shqipe.


Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është akredituar për herë të parë me vendim Nr.282 datë 04.07.2012 nga ASCAL. Më pas me Vendimin nr.71 datë 04.10.2019 programi është ri akredituar për një periudhë 5 vjeçare.

Gjatë kësaj periudhe deri në vitin 2024 janë bërë disa ndryshime në programin e studimit brenda nivelit të 20 % të lejuar nga kuadri ligjor në fuqi.

Departamenti i Financë Kontabilitet ofron aktualisht dy programe studimi: Këtë program studimi Bachelor në Financë Kontabilitet dhe programin e studimit Master Profesional në Financë Kontabilitet.

Programi Bachelor në Financë Kontabilitet reflekton përvojën më të mirë të programeve të ciklit të parë në financë dhe kontabilitet në vendin tonë. Ky është akreditimi i tretë që do të krijojë mundësinë për përmirësime në vijim, në përputhje të Ligjit Nr.80/2015 të Arsimit të Lartë, udhëzimet që pasuan atë, si dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Prioritetet e programit Bachelor në Financë Kontabilitet janë në përputhje të plotë me ato të KUL dhe që synon të jetë i suksesshëm për studentët në tregun e punës.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

ASCAL, bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Drini Salko dhe Prof. Dr. Dorina Kripa. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL-it Msc. Arbri Ndreka.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet", i ofruar nga Departamenti i Financë Kontabilitetit të Fakultetit të Ekonomik pranë KUL, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentat përkatëse në mbështetje të tij në platformën e institucionit. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në FE të KUL, u realizua në datën 16 dhe 17 Tetor 2024, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në FE të KUL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësen e Departamentit të Financë Kontabilitetit dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, studentët e këtij programi, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit Bachelor në FK, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse.

Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.71, datë 04.10.2019 janë:

1. *Institucioni të realizojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës për këtë program studimi.*
2. *Institucioni të pasurojë bibliotekën me literaturë ndihmëse në funksion të programit të studimit.*

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

GVJ bazuar në rekomandimet e Bordit të Akreditimit të vendimit nr.71.datë 04.10.2019, shqyrtoi plotësimin e dy rekomandimeve të mësipërme dhe konkludon:

Për rekomandimin nr.1. *Institucioni të realizojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës për këtë program studimi.*

Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it, evidentohet realizimi i një studimi të tregut të punës në funksion të këtij programi. Ne vlerësojmë se studimi i tregut financiar e bankar është i plotë dhe i shërben diplomimit dhe punësimit të studentëve të këtij programi. Studimi është i gërshtuar edhe me kërkesat e aktoreve të tregut të punës (biznese dhe institucione financiare) për të diplomuar në fushën e financës dhe kontabilitetit.


Bazuar në këtë evidentim, GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar plotësisht.

Për rekomandimin nr.2. *Institucioni të pasurojë bibliotekën me literature ndihmëse në funksion të programit të studimit.*

Gjate vizitës në institucion, GVJ ishte prezent edhe në ambientet e bibliotekës së KUL për të evidentuar plotësimin e këtij rekomandimi si dhe të dhënat e paraqitura në RVB dhe anekset e tij mbi literature bazë dhe ndihmëse në funksion të këtij programi. Ne evidentuam që biblioteka e KUL gjatë viteve të fundit është pasuruar me një literaturë të bollshme në fushën e financë kontabilitetit. Këtu përfshihen tekste në gjuhë të huaj dhe shqipe (64 tituj në fushën e ekonomisë) që mbulojnë lëndë të fushës së financë kontabilitetit, revista periodike si dhe cikle leksionesh për lëndët e programit.


Gjithashtu, evidentuam edhe përdorimin e literaturës në versionin elektronik (PLEIADES) si dhe aksesin online të bibliotekave JSTORE dhe EBSCO si një alternative bashkëkohore për studentët në shfrytëzimin e literaturës.

Bazuar në këtë evidentim, GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar plotësisht.



LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Larte
DFK	Departamenti i Financë Kontabilitetit
FE	Fakulteti i Ekonomisë,
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
KPSSC	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë
FK	Finance Kontabilitet
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
KUL	Kolegji Universitar “LOGOS”
RASH	Rrejtë Akademik Shqiptar
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
SBC	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



Më datë 10.02.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.62/3 Prot., datë 10.02.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 17.02.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr.62/5 Prot., datë 17.02.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin me shkresën përcjellëse nr.40/1 Prot. Datë 14.02.2025, sqaron si vijon:

Standardi II.1:Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

1. Lidhur me komentet e institucionit për *Standardin II.1, kriteri 2*, GVJ arsyeton se, pavarësisht qëllimit të programit për një formim të përgjithshëm në fushën e ekonomisë 3 lëndët jo karakterizuese të përmendura në raportin tonë mund të riorganizohen në një lëndë me tre modulet përkatëse gjë që do të kërkonte përmirësime në syllabuset për to me trajtime të fushës së financës apo kontabilitetit. Po ashtu siç edhe e pranon institucioni mund të shihet mundësia e shtimit të lëndëve me zgjedhje.

Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë dhe Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

Standardi II.1: Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

2. Lidhur me komentet e institucionit për *Standardin II.1, Kriteri 3*, GVJ arsyeton se përcaktimi ynë për tre lëndët që i kemi konsideruar tek veprimtaria D në fakt nga institucioni janë tek veprimtaria C. Ndërsa sugjerimi ynë që këto janë lëndë karakterizuese qëndron, gjë që e ka pranuar edhe vetë institucioni.

Si rrjedhojë, Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht vetëm për referimin e tre lëndëve në veprimtarinë e vendosur nga institucioni.

Standardi II.3:Programi i studimit përmban informacionin e nevojshëm për programet lëndore (syllabuset).

3. Lidhur me komentet e institucionit për *Standardin II.3, Kriteri 4*, GVJ arsyeton se qëndron argumenti i institucionit por vetëm për vitin e botimit të literaturës bazë në gjuhën shqipe të autorëve vendas, por qëndron vlerësimi ynë për disa syllabuse që i referohen literaturës së huaj relativisht të para viteve 2015. Për këtë në raport do të përcaktojmë “si numër të kufizuar” referencën tonë për këto syllabuse.

Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, por me saktësimin e shprehur më lart.

Standardi III.4.Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.

4. Lidhur me komentet e institucionit për standardin III.4, GVJ vëren se institucioni do e marrë në konsideratë .

Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë dhe Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Kolegji Universitar “LOGOS” (KUL) është institucion privat i Arsimit të Lartë jofitimprurës i themeluar në vitin 2008 me seli në Tiranë dhe që funksionon juridikisht dhe financiarisht brenda Fondacionit “LOGOS”. Institucioni është akredituar me Vendim nr.58. datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL-it. Programi i studimit të ciklit të I-rë Bachelor në “Financë Kontabilitet”, (FK) i ofruar nga KUL, Fakulteti i Ekonomisë (FE), Departamenti i Financë Kontabilitetit (DFK), në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program në fushën e financës dhe kontabilitetit ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studentëve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në sektorin financiar. Programi i studimit Bachelor në FK është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në Strategjinë e Zhvillimit në KUL 2018-2024. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore, standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar edhe në Statutin e KUL (Kreu 1, Neni nr.3, Misioni dhe Qëllimi). Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit në përgjithësi dhe fushës së financës apo kontabilitetit në veçanti e përcaktuar edhe në rregulloren e këtij programi (neni 3, Mision). <i>Evidenca nr.1.Statuti i KUL</i> <i>Evidenca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Programi i studimit Bachelor në FK është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të KUL-së dhe FE si njësi kryesore e tij, të shprehura në Statutin e KUL (neni nr.3), Strategjinë e Zhvillimit të KUL 2018-2024 si dhe rregulloren e vetë programit të studimit në Financë Kontabilitet me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike, shkencore dhe praktike në fushën

institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	e financës, bankës, kontabilitetit dhe menaxhimit të riskut. Në funksion të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë kryesore të këtij programi, FE dhe DKF si njësi bazë që mbulon këtë program. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me aplikimin e programeve bashkëkohore në fushën e financës dhe kontabilitetit”. <i>Evidenca nr.1.Statuti i KUL</i> <i>Evidenca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në FK është hartuar në përputhje me Statutin e KUL dhe Planin Strategjik të tij 2018-2024 si dhe në dokumentet bazë rregullative të KUL edhe në rregulloren e këtij programi neni 3:objektiva të programit, faqe 2 theksohet pajisja e studenteve me njohuritë bazë përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me synimin e formimit të specialistëve të lartë në fushën e financës dhe të kontabilitetit për të qënë të aftë në tregun e punës. Ky program studimi i hapur me urdhër të MASH nr.1 datë 06.01.2011 dhe akredituar me Vendimin e Këshillit të Akreditimit nr. 338, datë 08.06.2012, reflekton synimin e institucionit dhe veçanërisht njësisë bazë të tij, DFK, për të zhvilluar këtë program bazuar në Planin Strategjik të KUL. <i>Evidenca nr.1.Statuti i KUL</i> <i>Evidenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Bazuar në eksperiencën relativisht e gjatë të operimit të institucionit, (që nga viti 2008 dhe marrjen e akreditimeve institucionale në vitet 2017 dhe 2021), strukturën akademike, kapacitetet dhe burimet njerëzore të njësisë kryesore, vlerësojmë se institucioni ofron garancinë për një program Bachelor në FK në përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij. FE si njësi kryesore dhe DFK që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Referuar tabelës1.1 për stafin akademik të FE si njësi kryesore e programit të studimit rezulton se kjo njësi përfshin tre Departamente: Departamentin e Financë kontabilitetit; Departamentin e Menaxhimit;

Departamentin e Agrobiznesit.

FE në vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje 15 PAE dhe 17 PAK.

DFK si njësi bazë e programit të studimit Bachelor në FK bazuar në tabelat anekse nr 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4. të RVB gjatë 4 viteve të fundit akademike ka pasur një numër të qëndrueshëm staf akademik por nën kufirin e plotësimit të kriterit ligjor të operimit të një njësie bazë, por KUL ka bërë marrëveshje me MAS, në lidhje me numrin minimal të stafit PAE në departament, që përbëhet si me poshtë:

2020-2021	2021-2022	2022-2023	2023-2024
(9 PA)	(9 PA)	(12 PA)	(16 PA)
6 PAE	5 PAE	5 PAE	5 PAE
3 PAK	4 PAK	7 PAK	11 PAK

Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe takimeve të zhvilluara në institucion, ky mosplotësim kriteri është sanksionuar në marrëveshjen e MASR me KUL "Për reduktimin e numrit të personelit akademik efektiv". Në këtë marrëveshje referuar nenit 3 të saj përcaktohet se institucioni mund të mos plotësojë kushtin e numrit minimal të personelit akademik me kohë të plotë për departamentin. Stafi i DFK ka kualifikimin e duhur akademik për të realizuar këtë program studimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit si dhe vizita në institucion, GVJ evidenton ofrimin nga institucioni të një infrastrukture të përshtatshme për realizimin me sukses të këtij programi.

Evidenca nr.1.Statuti i KUL, organi grama e KUL si aneks i Statutit

Evidenca nr.28. Marrëveshjen e MASR me KUL për reduktimin e numrit të personelit akademik efektiv

Evidenca nr 29. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit

Evidenca : Aneks tabelat përmbledhëse Evidencë Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 2.3. në RVB

Evidenca Aneks tabele shtese 2.4.

Vizita e GVJ ne ambientet e KUL

Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë

Bazuar në rregullores së FE, rregulloren e DFK si dhe rregulloren e këtij programi studimi vihet re se ofrimi i këtij programi është në fushën e përgjithshme të ekonomisë që është fokus i njësisë kryesore (FE) dhe financë kontabilitetit që është fokus i njësisë bazë (DFK).

Bazuar në CV-e personelit akademik (PAE dhe PAK) që zhvillon këtë program, konstatojmë se profili i tyre akademik dhe fusha e

kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	kërkimit shkencor përkojnë kryesisht me fokusin e programit të studimit Bachelor në FK. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të KUL si dhe nga takimi me personelin akademik të programit, konstatuam angazhim të tyre në projekte kërkimore shkencore në fushën e financës. Programet e studimit në FE dhe në DFK organizohen në dy nivele Bachelor dhe Master edhe në fushën e financës dhe kontabilitetit duke synuar të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare brenda dhe jashtë vendit. <i>Evidenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK.</i> <i>Evidenca nr 29. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit</i> <i>Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 3. në RVB</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e dosjes së aplikimit pranë ASCAL-it si dhe vizitën e realizuar në institucion, konkludon se programi i studimit Bachelor në FK është në përputhje me misionin dhe qëllimin e KUL të shprehura në kuadrin ligjor dhe rregullativ. Ky program është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore FE dhe asaj bazë DFK duke ruajtur interesat kombëtare. Institucioni ofron kapacitetet akademike dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin me sukses të këtij programi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e	Bazuar në organigramën e KUL dhe vizitës së GVJ në institucion shohim që në strukturën e tij krahas organeve drejtuese statutore operojnë tre fakultete si njësi kryesore me strukturat përkatëse të njësive bazë dhe ato ndihmëse. Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda KUL dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësiave mes njësive kryesore, njësive bazë dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sërë aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	statutin (Kreu II) rregullore e KUL, rregullore e programit të studimit Bachelor në FK dhe në udhëzime që përcaktojnë procedurat në funksion të këtij qëllimi. Po ashtu janë një sërë aktesh të tjera që dispijlojnë punën e dekanatit, departamentit, sekretarisë mësimore, zyrës së burimeve njerëzore apo hallkave të ndryshme të institucionit në të cilat përcaktohen rolet, funksionet dhe ndarja e përgjegjësive e tyre të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes së programit të studimit. Struktura e institucionit përfshin të gjitha hallkat e nevojshme në funksion të procesit mësimor shkencor ashtu edhe të zbatimit dhe monitorimit të standardeve të cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies duke përfshirë edhe ato në funksion të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore (NJSBC, Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë) <i>Evidenca nr.1.Statuti i KUL,</i> <i>Evidenca nr.2.Rregullore e përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.18.Organigrama e KUL</i> <i>Evidenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK .</i> <i>Evidenca nr.24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 3. në RVB</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në funksion të realizimit të objektivave mësimore dhe formuese të studentëve KUL, ka nënshkruar një numër marrëveshjesh bashkëpunimi: - Marrëveshje bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit; - Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera që përfshijnë edhe aktore të biznesit; - Marrëveshje bashkëpunimi me institucione jo arsimore. Një pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit janë realizuar kryesisht nëpërmjet projekteve të përbashkëta si Tempus, ERASMUS +, etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj. Në kuadër të njësisë kryesore janë realizuar 14 mobilitete të studentëve nga dhe drejt programit të studimit. Bazuar në pasqyrat anekse të RVB në nivel njësie kryesore shihet se kjo njësi aktualisht është pjesë e një projekti ndërkombëtar. Gjithashtu ky bashkëpunim është materializuar përmes realizimit të 11 leksioneve të hapura me lektore të huaj si dhe 36 pjesëmarrjeve nga stafi i FE në aktivitete shkencore jashtë vendit.



	<i>Evidenca nr.36. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL dhe IAL brenda dhe jashtë vendit</i> <i>Evidenca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL me biznesit</i> <i>Evidenca nr.38. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet jo arsimore</i> <i>Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.20 të RVB</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se KUL ka marrëveshje me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në FE, pedagogët u shprehën, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrierën të tyre. Në kuadër të këtij programi janë me interes marrëveshjet e KUL me institucione apo aktore të tillë të biznesit të fushës së financë kontabilitetit, të tilla si: banka tregtare, institucione të tjera financiare (mikrofinanciare), Zyra të këmbimit valutor etj. <i>Evidenca nr.31.Mobilitete te stafit dhe studenteve</i> <i>Evidenca nr.36. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL dhe IAL brenda dhe jashtë vendit</i> <i>Evidenca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL me biznesit</i> <i>Evidenca nr.38. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet jo arsimore</i> <i>Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.20 të RVB</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	DFK si njësia bazë dhe përgjegjëse e këtij programi evidenton nëpërmjet raporteve periodike të analizës vjetore përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me të tretët. Ne evidentuam në raportin periodik të prezantuar në aplikim ku trajtoheshin rezultatet e bashkëpunimit nëpërmjet të dhënave të shkëmbimeve të studentëve dhe stafeve në kuadër të marrëveshjeve me institucione homologe jashtë vendit, realizimin e intershipeve të studentëve pranë institucioneve dhe bizneseve vendase. <i>Evidenca nr. 21. Raporti vjetor institucional për tre vitet akademike 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023</i> <i>Evidenca nr. 22. Raporti vjetor i FE për tre vitet akademike, 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023</i> <i>Evidenca nr. 23. Raporti vjetor i DFK për tre vitet akademike 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023</i>

	Vizita në institucion në takime me stafin akademik dhe studentet.			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FK bazohet në një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi mes KUL dhe institucioneve mësimore shkencore brenda dhe jashtë vendit apo aktore të sipërmarrjeve të ndryshme duke mundësuar dhe marrjen e eksperiencës apo realizimin e praktikës profesionale të studentëve pranë tyre. Gjithashtu, në kuadër të këtyre marrëveshjeve gjatë 3 viteve të fundit janë realizuar një numër i kënaqshëm mobilitetesh (14 të tilla) duke patur parasysh numrin modest të PAE dhe të studentëve të këtij programi			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në "FK "që ofrohet nga DFK i Fakultetit të Ekonomisë pranë KUL është i organizuar në 37 lëndë (përfshirë praktikën profesionale) të cilat vlerësohen me kredite përkatëse në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë. Programi bazohet në Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) dhe parimeve të Kartës së Bolonjës. Programi është me një kohëzgjatje 3 vite akademike e ndarë në 6 semestra dhe që përfshin 180 ECTS dhe me një ngarkesë javore 25 orë. <i>Referenca nr.24 .Plani mësimor i programit të studimit</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al


	<i>Referenca nr.26. Syllabuset e programit të studimit Bachelor ne FK</i> <i>Aneks tabelash (tabela nr. 10)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Duke shqyrtuar programin mësimor si dhe përmbajtjen e syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës dhe kontabilitetit. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë në financë apo kontabilitet brenda hapësirës së njohurive të një programi Bachelor si dhe të mund të vazhdojnë programin e ciklit të dytë në profilet e këtij programi pas diplomimit të tyre. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/ modulet me gjithë ngarkesën e tyre në mënyrë që të përmbushen më mirë objektivat e mësimnxënies nga ana e studentëve do të sugjerohet disa rregullime kryesisht teknike që nuk prekin përmbajtjen e programit të propozuar. Kështu: 1. Bazuar në fushën e programit me fokus financën dhe kontabilitetit programi mund "të lehtësohet" nga lëndë të menaxhimit të fushës jo financiare. Janë tre lëndë që zhvillohen në kursin e dytë përkatësisht "Menaxhim i Burimeve Njerëzore, "Menaxhim Operacional" dhe "Menaxhim Marketingu " te cilat mund të jenë tre module të një lënde. Kjo do kërkojë edhe rregullime në syllabuset e këtyre tre moduleve . Studentët e një programi në fushën e financës dhe kontabilitetit kanë marrë në këtë program njohuritë bazë të menaxhimit që në semestrin e parë të vitit të parë. 2. Në program të mund të zinin më shumë peshë lëndët me zgjedhje që në programin aktual kemi vetëm një lëndë në semestrin e V-të, gjë që do të plotësonte më mirë programin me njohuri bashkëkohore në financë dhe kontabilitet. Përfshirja e njohurive bashkëkohore nëpërmjet lëndëve apo moduleve të shërbimeve financiare digjitale do rriste më tej nivelin e programit të studimit. <i>Referenca nr.24 .Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Referenca nr.26. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK.</i> <i>Referenca: Aneks tabelat (tabela nr. 10)</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese	Mbështetur në pasqyrën e hartuar nga institucioni "Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese" evidentojmë se organizimi i kurrikulës respekton kriteret e përcaktuara në




duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	VKM nr 41, datë 25.01.2018 sipas tipit të veprimtarisë nga A tek E si më poshtë: Lëndët e kategorisë A zënë 18 % të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 20 % që është kriteri; Lëndët e kategorisë B zënë 52 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 55 % që është kriteri; Lëndët e kategorisë C zënë 12.5. %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri; Lëndët e kategorisë D zënë 14.5 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri; Lëndët e kategorisë E zënë 3.3 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 5 % që është kriteri; Bazuar në kriteret e miratuara për një program Bahelor shohim se struktura e programit përmbush kriteret e vendosura. <i>Megjithatë GVJ mendon se lënda e "Menaxhim i Burimeve Njerëzore", Sipërmarrja dhe Menaxhimi i SME-ve dhe "Menaxhimi i Marketingut" që janë përfshirë tek Veprimtaria B karakterizuese nuk përkon me natyrën e lëndëve të kësaj kategorie dhe duhet të përfshihen tek veprimtaria D. Gjithashtu, lëndë të Grupit C si "Menaxhim Risku", "Auditim" dhe "Teknike bankare " të jenë tek veprimtaria B.</i> <i>Referenca nr.24 .Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Referenca nr.26. Syllabuset e programit te studimit Bachelor ne FK</i> <i>Referenca. Aneks tabelash (tabela nr. 9)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit është mbështetur në plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore përfshin si komponent më vete praktikën profesionale e cila zhvillohet menjëherë pas përfundimit të procesit mësimor dhe përpara diplomimit të studentëve. Praktika profesionale në planin mësimor është e planifikuar me 150 orë totale dhe me 6 kredite (sistemi ETCS). <i>Referenca nr.24 .Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Referenca nr.26. Syllabuset e programit te studimit Bachelor ne FK</i> <i>Referenca. Aneks tabelash (tabela nr. 9)</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet	Institucioni mbështetur në kërkesat dhe kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi ka hartuar "Rregullorja e përgjithshme e KUL. Në këtë dokument janë të përcaktuara procedurat dhe fazat e procesit të pranimit vlerësimit, transferimit dhe




e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	financimit të studentëve. Në këtë program nuk ka pasur praktikë pranimit dhe financimi të studentëve me status të veçantë. <i>Referenca: nr.2. "Rregullorja e përgjithshme e KUL"</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	KUL ofron vetëm këtë program studimi në Bachelor në FK. Nga informacioni që GVJ ka, rezulton se programi Bachelor me këtë emërtim në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri zhvillohen në disa prej tyre. IAL të tilla janë Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës, Fakulteti i Biznesit etj. Përmbajtja e programit duke marrë për bazë fushën e financës dhe kontabilitetit në kuadër të gjerë përmban në pjesën më të madhe lëndë që zhvillohen në programe të ngjashme Bachelor brenda dhe jashtë vendit (mbi 70 % e programit është e njëjtë). <i>Referenca nr.24 .Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Referenca nr.26. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca. Aneks tabelash (tabela nr. 9)</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi është në proces kodifikimi në kuadër të zbatimit të VKM nr.310 datë 11.05.2022" Ashtu siç e kemi theksuar me lartë KUL ka bërë kërkesën për kodifikim të një numri programesh që zhvillohen pranë MASR dhe është në pritje të vendimit. <i>Referenca: nr.79.Procedura për kodifikimin e programit të studimit ofruar nga KUL.</i> <i>Referenca Vizite dhe takime në Institucion</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi Bachelor në FK, aktualisht nuk është një program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas apo të huaj.
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi i studimit Bachelor në FK organizohet në përputhje me aktet</i>




	<i>ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij sugjerimet e GVJ në kriterin nr.2 dhe 3 të këtij standardi do i shërbenin këtij procesi. Këto ndryshime të propozuara në program nga GVJ konsistojnë në rritjen e njohurive karakterizuese të programit si dhe në përfshirjen më shumë të lëndëve me zgjedhje si mundësi më e madhe për studentët në marrjen e njohurive preferenciale prej tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	FE si njësi kryesore përgjegjëse e programit të studimit Bachelor në FK përmbush detyrimet ligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafet akademike për zhvillimin e këtij program. Në vitin akademik 2022-2023 FE përfshin në strukturën 32 anëtarë si personel akademik nga të cilët 15 anëtarë janë PAE dhe 17 anëtarë janë PAK, që janë pjesë e tre Departamenteve : 1. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit; 2. Departamenti i Menaxhimit 3. Departamenti i Agrobiznesit Njësia bazë (DFK) si njësi bazë dhe përgjegjëse e programit të studimit Bachelor në FK gjatë tre viteve të fundit ka pasur një numër të qëndrueshëm stafit por nën kufirin minimal të kërkuar (janë 5 anëtarë PAE), por që e kemi theksuar me lart ky numër është në përputhje me marrëveshjen që institucioni ka me Ministrinë e Arsimit. Për vitin 2023-2024 nga 5 PAE 1 prej tyre është i kategorisë “Profesor”, 2 mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe 2 janë në proces doktorature të regjistruar pranë IAL. Nga 11 anëtarët e PAK 2 janë të kategorisë Profesor i Asociuar dhe 7 mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe 2 janë MSc: <i>Referenca nr.1.Statuti i KUL, organigrama e KUL si aneks i statutit</i> <i>Referenca nr.18.Organigrama e KUL</i> <i>Referenca: Aneks tabelat përmbledhëse Evidencë Tabela nr.1.1; 1.2; dhe 1.4. në RVB</i> <i>Evidenca Aneks tabele shtese 2.4.</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga DFK përgjegjëse për programin e studimit. Departamenti cakton një pedagog i cili është përgjegjës për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional dhe karrierës në auditor. Gjithashtu, nga vizita në institucion dhe në ambientet laboratorike institucioni ka angazhuar 2 personel ndihmës akademik që ndihmojnë personelin akademik në realizimin e punëve laboratorike apo në ndihmë të procesit mësimor që në strukturën dhe që mbikëqyrin anën teknike të pajisjeve teknike. Këta persona nuk janë të përfshirë në strukturën e njësisë baze dhe kryesore por në nivel institucioni. <i>Referenca: Vizita në institucion e GVJ dhe takimi me drejtuesit e institucioni</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ bazuar në vizitën realizuar në KUL dhe dosjen e aplikimit, konfirmon se DFK si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në FK ka caktuar si koordinator të programit, Përgjegjësin e kësaj njësie një nga PAE të departamentit e cila është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në auditor si edhe për ndjekjen e praktikave në institucione apo njësi të tjera ekonomike. Detyrat dhe funksionet e koordinatorit janë të përcaktuara në rregulloren e DFK <i>Referenca nr.4. Rregullore e DFK</i> <i>Referenca nr.44. Vendimi nr.25 date 25.09.2021 i Dekanit të FE për caktimin e koordinatorëve të programeve</i> <i>Vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, shpreh se njësia kryesore FE dhe ajo bazë DFK përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Fakulteti i Ekonomisë përfshin 3 departamente si njësi baze duke plotësuar kriterin ligjor. Departamenti i Financë Kontabilitetit ka si PAE 5 punonjës akademik nga 7 të tillë që duhet të ketë një njësi bazë. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe takimeve të zhvilluara në institucion, ky mosplotësim kriteri është sanksionuar në marrëveshjen e MASR me KUL “Për reduktimin e numrit të personelit akademik efektiv”</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gimn. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-47423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe në vizitën e realizuar në institucion GVJ evidenton se FE si njësi kryesore dhe DFK si njësi bazë e programit kanë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi. Staf i akademik në këto njësi njeh rregulloren e këtij programi, planin mësimor dhe përmbajtjen e programit të lëndëve përkatëse që zhvillohen. Informacion rreth programit gjendet dhe në faqen e internetit të institucionit dhe është i aksesueshëm edhe për studentët. <i>Referenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ evidentoi dhe shqyrtoi planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”, shtojcën e ndryshimeve të tij në tabelat përmbledhëse, syllabuset e lëndëve në të cilat përfshihet informacioni i plotë për ndarjen e lëndëve në semestrale, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor si leksionet ashtu edhe seminarët, orët jashtë auditorit si puna e pavarur, si dhe të gjithë komponentët formues të programit, duke respektuar VKM nr.41.datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit” e ndryshuar “. <i>Referenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Studentët nëpërmjet planit mësimor dhe kuadrit rregullator të brendshëm (rregulloret e studimit në rang institucional, njësi kryesore/bazë dhe nivel programi kanë informacionin e duhur që në procesin e pranimit, regjistrimit dhe zhvillimit të programit ashtu edhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.




	<i>Referenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr. 70.Vendimi për kriteret e pranimit në programin e studimit Bachelor në FK</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Duke shqyrtuar programet e lëndëve (syllabuset) vërejmë se ato janë ndërtuar si strukturë dhe në përmbajtje kryesisht në zbatim të VKM nr.41.date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit” e ndryshuar, ku përfshihen: • Emërtimi i lëndës/modulit; • Viti/semestri kur zhvillohet lënda dhe raporti i orëve në auditor; • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës; • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik; • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; • Format e vlerësimit të studentëve; • Detyrimet e studentit për lëndën; • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse; Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kurse, provime të ndërmjetme dhe provim final. në të gjitha programet e lëndëve vlerësimi i vazhduar zë një peshë specifike 30% deri 40% duke plotësuar këtë kriter. <i>Nga shqyrtimi i përmbajtjes lëndore vërejmë se në një numër të kufizuar të syllabusve literatura e rekomanduar i referohet viteve të hershme përpara vitit 2015 gjë që tregon mos reflektimin në program të botimeve të 5 viteve të fundit.</i> <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i>




	<i>Referenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it si dhe vizitën e GVJ në ambientet e KUL shohim që pas periudhës së licencimit janë bërë tre axhustime lëndësh në program në lëndët e Matematikës, statistikës dhe analizës financiare. Këto ndryshime në program janë brenda kufirit prej 20 % të lejuar 3 lëndët e mësipërme. Ndryshime janë bërë gjatë këtyre viteve edhe në syllabuset e lëndëve duke rifreskuar ato me informacion të kohës. <i>Siç e kemi theksuar edhe më lart, është e nevojshme që programi mësimor të përmirësohet më tej me sugjerimet e dhëna më lart.</i> <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr.25.Procedura për ndryshimin e kurrikules</i> <i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është i strukturuar dhe organizuar kryesisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe me objektivat formuese të këtij programi. Në këtë kontekst është e nevojshme përmirësimi në strukturë por sidomos në referimin e literaturës me të fundit për disa nga lëndët e programit duke rritur cilësinë e programit lëndor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,	Programi në emërtim dhe përmbajtjen e tij ofron tiparet e një programi studiimi të nivelit Bachelor në fushën e financës dhe kontabilitetit. Programi synon të kombinojë njohuritë teorike në këtë fushë me ato praktike. Këtë e shikojmë në përmbajtjen

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në treg. Emërtimi dhe përmbajtja jo vetëm u mundëson punësimin në përfundim të studimeve në financë apo kontabilitet por të diplomuarit në këtë program mund të vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve Master në një spektër me të gjerë të financës, kontabilitetit dhe auditimit. <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në të katër drejtimet e tij. Duke analizuar programin shohim që studentët: - në vitin e parë marrin njohuritë bazë makro dhe mikroekonomike, matematike, statistike dhe konceptet në menaxhim dhe kontabilitet të domosdoshme për çdo program të fushës së ekonomisë; - në vitin dytë në disa nga lëndët që zhvillohen merren njohuri kryesisht të financës dhe kontabilitetit por edhe te menaxhimit apo marketingut etj; - në vitin e tretë programi ofron njohuri me specifikë lidhur me financën, bankave, menaxhimin e riskut dhe auditimint të cilat krahas praktikës profesionale finalizohen me detyrimet përmbyllëse; Mbështetur në lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e	Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialiste në fushën e financës dhe kontabilitetit. Mbështetur në strukturën




programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është financa dhe kontabiliteti. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimit të studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Në kuadër edhe të projektit të përbashkët në hartimin e këtij programi është bashkëpunuar edhe me universitetet analoge të disa prej vendeve të BE. Zhvillimi i këtij programi studimi është bazuar edhe në një studim tregu me operatorët kryesor të tij nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve të fokusuar në objektin e programit. <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Përmbajtja e programit të studimit harmonizon përmbajtjen teorike me atë praktike. Nga shqyrtimi i syllabusve të lëndëve karakterizuese të programit shohim që në to një pjesë e temave u referohen rasteve studimore apo praktikave laboratorike. Përmbajtja e tyre është e bazuar në përmbajtjen e lëndëve të tilla edhe në universitetet e huaja duke mundësuar ekuivalentimin në rast transferim studimi. Duke analizuar planin mësimor dhe programin mësimor të prezantuar në aplikimin e institucionit si dhe nga bashkëbisedimi me stafin që mbulon këtë program, vërejmë se ka një raport të drejtë mes formimit teorik dhe atij praktik të studentëve. Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve shikojmë se në to kemi si trajtime teorike të avancuara ashtu edhe aplikime kryesisht në fushën e kontabilitetit. Trajtimi i rasteve studimore, punëve laboratorike dhe realizimit të praktikës mësimore harmonizon realizimin e objektivave të këtij programi. <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca: Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</i>

Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Siç e kemi evidentuar më lartë, GVJ konstatoi përditësim në programet e lëndëve. Në vlerësim, <i>mbeten rekomandimet e GVJ, të dhëna më sipër me qëllim përmirësimit të tyre por edhe si reflektim i zhvillimeve të fundit në tregun financiar dhe kontabël.</i> <i>GVJ evidenton mangësitë në syllabuse të theksuara më lartë (standardi 2.3. kriteri 4)</i> <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca: Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi Bachelor në “Financë Kontabilitet” i pajis studentët që zotërojnë tashmë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhimit të riskut. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të teknikave të vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve në sektorin financiar, kryesisht privat, si dhe në sektorët e tjerë të ndikuar nga risqet të natyrave të tjera. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin financiar dhe real të ekonomisë. <i>Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Referenca nr.24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca: Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por edhe në ato ndërkombëtare. Përmbajtja e programit është e tillë që nëpërmjet njohurive të marra në të katër drejtimit të tij, të bëjë të mundur për studentët e diplomuar vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të programit Master. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve në katër drejtimit të tij. Specifikimi që në emërtim i këtyre katër drejtimeve është përparësi në mundësinë e punësimit të të diplomuarve dhe kjo sidomos në tregun financiar.




	Referenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Referenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK Referenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK Referenca: Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.			
Konkluzione	Struktura dhe organizimi i programit janë në përputhje me objektivat formuese dhe kualifikimin sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimit dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Nga verifikimi i syllabusve të lëndëve të programit GVJ evidentoi plotësimin në përmbajtje dhe strukture të elementeve të nevojshëm të një programi bazuar në kriteret rregullative të vendosura nga MAS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	FE si njësi kryesore dhe DFK si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij programi bazuar në rregulloren e programit dhe marrëveshjet institucionale me aktorët e tregut të punës analizojnë periodikisht mundësitë e përmirësimit të programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt. Lidhur me këtë program, ne evidentuam përmirësimet në programin e studimit gjatë 3 viteve të fundit që kanë konstatuar në përmirësimin në përmbajtje dhe në emërtim për tre lëndë të përmendura edhe më lartë). Nga takimi me stafin akademik të programit evidentuam ndryshime në përmbajtjen lëndore në syllabuse në kuadër të lirisë akademike. Gjithashtu, nga diskutimi me stafin akademik që zhvillon këtë program, evidentuam përmirësim në ciklet e leksioneve të lëndëve që ata mbulojnë kryesisht me trajtime aplikative të lidhura me drejtimin financiar dhe menaxhimin e riskut. Evidenca nr.5 Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.11. Vizita e GVJ në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentet

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Bazuar në vizitën pranë KUL si dhe nga takimi me studentët e programit, Këshillit studentor dhe pjesëtarë të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, si edhe nga rregullorja e kësaj zyre, rezulton se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar. Po ashtu edhe DFK zhvillon diskutime me studentë të këtij programi mbi përmirësimet të mundshme në program. Në funksion të këtij qëllimi realizohet dhe pyetësi për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët, por <i>GVJ nuk evidentoi propozime nga studentët për përmirësimet në programin e lëndëve.</i> <i>Evidenca 116. Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</i> <i>Evidenca: Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.11</i> <i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	DFK mban kontakte periodike me studentët e programit, Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës në funksion të përmirësimit të programit dhe qasjes së tij me tregun e punës. GVJ e evidentoi këtë proces gjatë takimit me stafin dhe studentet e programit. <i>Evidenca 116. Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</i> <i>Evidenca: Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.11</i> <i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ evidenton përkushtim të FE dhe DFK në përfshirjen e studentëve dhe aktorëve të tjerë në përmirësimin e programit të studimit me qëllim përmirësim të mundshëm të programit në funksion të nevojave të tregut financiar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Mësimdhënia në programin Bachelor në “FK” bazohet në kuadrin rregullator në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë. Në funksion të këtij procesi janë përkatësisht rregullorja e studimeve në KUL; rregullorja e FE, rregullorja e DFK dhe vetë rregullorja e programit të studimit Bachelor në FK në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, praktika profesionale etj, të organizuara në 37 lëndë, ku janë parashikuar teste të ndërmjetme, detyra kursi, provim përfundimtar dhe tema e diplomës në përmbyllje të studimeve. Në planin mësimor orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit si angazhim individual i studentit janë të përcaktuar sipas të gjitha elementëve të një programi të nivelit Bachelor. Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit, forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, që do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat përgjithësisht janë të ndara në: • frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit; • testi i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit; • provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit; Mënyra e vlerësimit të studentëve është prezantuar në syllabusin e çdo lënde dhe ne evidentuam që vlerësimi i vazhduar është në nivelin e 40 % të pikëve totale. <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i>

	<i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Pozitive është fakti që stafi i programit ka realizuar mobilitete të ndryshme në kuadër të projekteve të institucionit, Bazuar në evidencën shtesë të kërkuar nga GVJ gjatë vizitës në institucion rezultojnë se 7 anëtarë të stafit akademik kanë realizuar mobilitete jashtë vendit në universitete partnere, kryesisht në Greqi. Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes së mendimit të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca praktike të mësimnxënies në lëndët aplikative. <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Referenca nr.30. Të dhëna për kualifikime dhe kërkim shkencor të stafit</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i> <i>Evidenca shtesë Mobilitete të stafit akademik</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve.	Bazuar në takimin me stafin e DFK rezultojnë se KUL mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja , mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS+ si dhe nëpërmjet aktiviteteve të organizuara me partnere vendas dhe të huaja në shërbim të këtij qëllimi. Së fundmi miratimi i udhëzuesit mbi metodat inovative të mësimdhënies dhe me e rëndësishmja aplikimi i këtij udhëzuesi në procesin mësimor është një mundësi e rritjes së cilësisë mësimdhënëse të personelit akademik. Në kuadër edhe të zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka përdorur edhe platformat e njohura të mësimdhënies online si e-learning Microsoft Teams apo Google Classroom të cilat ishin dhe metoda kryesore gjatë periudhës së pandemisë COVID 19.

	<i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr. 95. Aktivitete të FE gjate tre viteve të fundit</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i> <i>Evidenca shtese Mobilitete të stafit akademik</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik që mbulon këtë program ka eksperiencën dhe kualifikimin e duhur akademike dhe pedagogjike për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e financës kontabilitetit dhe menaxhimit në përputhje me lëndët që karakterizojnë drejtimit përkatëse. Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Është praktikë e procesit mësimor që në fund të zhvillimit të lëndës si dhe para se vlerësimi i lëndës të gjenerohet në sistem realizohet një takim mes pedagogut dhe studentëve. <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Shtojca nr.29. CV e stafit akademik</i> <i>Shtojca nr.31.Mobilitete të stafit akademik</i> <i>Eviudencea nr. 95. Aktivitete te FE gjate tre viteve te fundit</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik dhe studentet</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	DFK si një njësi bazë e konsoliduar luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e programit të studimit. Nga ana tjetër është bërë e mundur përfshirja e studentëve në vlerësimin e mësimdhënies dhe stafit akademik. Krahas përvojës mësimdhënëse që stafi i programit ka marrë nëpërmjet mobiliteteve të programit ERASMUS+, në KUL janë realizuar edhe trajnime pedagogjike me stafin e ri akademik. Në funksion të këtij qëllimi realizohet dhe pyetëtori për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët. <i>Evidenca 116.Pyetesor për vlerësimin e cilësisë se mësimdhënies</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	KUL krahas akteve rregullatore në funksion të procesit mësimor shkencor institucioni ka të ngritura tre struktura që monitorojnë, vlerësojnë dhe përmirësojnë procesin mësimor shkencor. Krahas Komisionin te Përhershëm te garantimit të cilësisë dhe komisionit të Përhershëm të marrëdhënieve me

mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	studentët, operon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si struktura kryesore e këtij procesi. Me vendim të Senatit të KUL Nr.1, datë 12.01.2024 është riorganizuar NJSBC ku është përfshirë edhe eksperti i jashtëm NJSBC, funksionon në bazë të rregullores përkatëse të saj. Në këtë rregullore sanksionohen funksionet dhe mënyra e operimit të kësaj njësie. Nga shqyrtimi i raporteve të NJSBC mbi organizimin e pyetësorëve me studentët vërehet një pjesëmarrje relativisht e ulët e tyre në këtë proces (për këtë program studimi). Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në takimet me pedagogun e lëndës kryesisht për rritjen e trajtimeve me karakter praktik dhe aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve. <i>Evidenca nr.116. Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies . Pyetësor studentor.</i> <i>Evidenca nr.96 Aktivitete e FE të KUL për tre vitet e fundit akademike</i> <i>Evidenca 111. Raport vjetor i NJSBC viti 2021-2022 dhe 2022-2023</i> <i>Evidenca nr.6.Rregullore për sigurimin e cilësisë</i> <i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se KUL realizon në procesin mësimor gjithë elementet e duhur të ndara në leksione ,seminare ,projekte e detyra kursi, praktikë profesionale etj. Institucioni në përbushje të akteve ligjore dhe nënligjore ka ngritur strukturat përkatëse që promovojnë vlerësojnë dhe mbikëqyrin përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të mësimdhënies. Nisur nga numri i ulët i studentëve në këtë program duhet të synohet që të gjithë studentët të jenë pjesë e realizimit të pyetësorëve të vlerësimit për këtë proces.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive,	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	(Rregullore e KUL), rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit. Këto dokumente janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse. <i>Evidence nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidence nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet: • Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në të; • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre; Bazuar në syllabusin e pedagogëve të programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet” dhe vizitës në institucion, u konstatua se pedagogu i secilës lëndë, javën a parë të mësimit bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. <i>Evidence nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidence nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidencë nr.26. Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit</i> <i>Takimi me stafin akademik gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde. <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Shtojca nr.26. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Takim gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e	Mendimi i studentëve për cilësinë e mësimeve dhe vlerësimi i tyre për performancën e pedagogut realizohet nëpërmjet organizimit nga Zyra e Sigurimit të Standardeve dhe Vlerësimit në bashkëpunim me NJSBC nëpërmjet anketimit.

mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Ky anketim realizohet në fund të çdo semestri. Raporti i rezultateve të dala hartohet nga kjo njësi dhe analizohet në DFK si njësi bazë e këtij program studimi. <i>Evidenca 111. Raport vjetor i NJSBC viti 2021-2022 dhe 2022-2023</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit u evidentua që realizimi i procesit mësimor nëpërmjet metodave të mirënjohura kombinohet me një qasje interaktive mes tyre duke nxitur diskutimet në grupin e tyre. Kjo realizohet edhe gjatë prezantimit të detyrave të kursit duke krijuar një ambient bashkëpunues. Grupi i studentëve në takim vlerësonte maksimalisht formën e diskutimit me grupin e tyre gjatë zhvillimit të mësimin. Numri i vogël i studentëve në kurs është edhe një faktor që ka nxitur këtë marrëdhënie interaktive mes pedagogut dhe studentit. Në funksion të këtij qëllimi janë edhe përdorimi i sistemit informatik Microsoft Office dhe Edu Page bazuar në Urdhrin nr.10. dt.22.03.2020 “Për përdorimin e platformës digjitale për mësimin në distancë”. GVJ evidentoi dhe aktivitete në funksion të këtij qëllimi siç ishte pjesëmarrja e studentëve të këtij programi në konkursin Stock Market Learning organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare <i>Evidence nr 63.Manuali i përdorimit të platformës Edupage.</i> <i>Evidenca nr.65.Udhezues në nivel institucional, metodat inovative të mësimdhënies</i> <i>Evidenca nr.66. Manuali i mësimdhënies online</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dijeve të studentëve gjatë procesit mësimor. Institucioni garanton realizimin e drejtë, vlerësimin e saktë të dijeve dhe aftësitë profesionale në procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të parë të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve në semestrin përkatës vlerësohen nga 30-40 % të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra/projektet e kursit si dhe testi i ndërmjetëm), ndërsa provimi përfundimtar zë 60 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Procesi i realizimit të vlerësimit është trajtuar edhe në rregulloren e programit dhe përfshin edhe aspekte të tjera të tij si sekretimin, kohën e shpalljes së rezultateve , ankimimin e studentët etj. Gjate tre viteve të fundit FE ka aplikuar për studentët e programit Bachelor në FK platformën Edupage si një mjet transparent komunikimi dhe informacioni mes pedagogut dhe studentit. GVJ evidentoi dhe zhvillimin online të procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë e paraprirë me rregulloren përkatëse dhe platformat e përdorura në këtë proces. <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FK.</i> <i>Evidenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr. 63.Manuali i përdorimit të platformës Edupage</i> <i>Takim gjate vizitës në institucion me stafin dhe studentet</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Pothuajse të gjitha vlerësimet e lëndëve të programit realizohen me shkrim në bazë të modelit të aprovuar të tezës së provimit. Institucioni në të tre nivelet e tij ka rregulloret përkatëse lidhur me format e zhvillimit të provimit ashtu edhe udhëzime për këtë proces. Për vetë faktin e numrit të ulët të studentëve në këtë program nuk aplikohet vlerësimi elektronik . <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore</i> <i>Evidenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Takim gjate vizitës në institucion me stafin dhe studentet</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Për realizimin e vlerësimit përfundimtar të dijeve të studentëve, DFK, bazuar në rregulloret përkatëse në nivel institucional dhe të vetë këtij programi, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i

	lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i DFK. <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore</i> <i>Vizite e GVJ dhe takim me sekretarinë mësimore dhe stafin akademik</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga DFK. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste zhvillimit të testimit në laborator shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit. Format i tezës së provimit ka si seksion më vete komentet e pedagogut për përgjigjet e studentit për pyetjet që kërkojnë qëndrim/opinion të studentit. Në fund të tezës është vlerësimi i detajuar sipas pyetjeve teorike dhe ushtrimeve. <i>Evidenca nr.3.Rregullorja e FE</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i> <i>Vizita në institucion e GVJ (pranë sekretarisë mësimore)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullator si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit evidentohet korrektësia e zhvillimi të provimit si me monitorimin nga dy pedagoge anëtarë të komisionit ashtu edhe moslejimi i përdorimit të celularëve apo formave të tjera të kopjimit. Mos lejimi i plagjiaturës apo kopjimi gjatë provimit janë të sanksionuar në rregulloren e KUL (neni 119 dhe 120) <i>Evidenca nr.2.Rregullorja e përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.3.Rregullorja e FE</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin përkatës por edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët evidentohet se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, ku pedagogu krahas realizimit të sekretimit të tezave shpall rezultatet e vlerësimit brenda kohës së parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 5 ditëve nga data e zhvillimit të tyre brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese (nga takimi me stafin akademik). Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet

	të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshim pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. GVJ evidentoi dhe një simulim konkret të hedhjes së pikëve të vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar të studentëve në platformën përkatëse. <i>Evidenca nr.2.Rregullorja e përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.3.Rregullorja e FE</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i> <i>Vizita në institucion e GVJ (me stafin akademik dhe pranë sekretarisë mësimore)</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në rregulloret përkatëse të studimit, studenti ka 3 ditë kohë pas shpalljes së rezultatit të vlerësimit që të bëjë ankesë nëse ai ka pretendime për një vlerësim më të lartë. Institucioni ka model formulari tip për ankimimin e studentit. Atij i jepet mundësia të ballafaqohet me pedagogun e lëndës dhe vlerësimin e bërë si dhe i jepet përgjigja edhe e shkruar në formular. Nga takimi me studentët e këtij programi gjatë vizitës në institucion ata nuk kishin pasur praktikë të tillë. Reklamimi për vlerësimin nuk kishte shkuar në këtë fazë pasi ishte zgjidhur gjatë takimit që pedagogu i lëndës zhvillon me studentët në datën e paracaktuar para se të hedhë vlerësimet përfundimisht në sistem. <i>Evidenca nr.2.Rregullorja e përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.3.Rregullorja e FE</i> <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i> <i>Vizita në institucion e GVJ (me stafin akademik dhe pranë sekretarisë mësimore)</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast të kërkesës për ankimim që bën student sipas formularit të miratuar pasi është ezauruar takimi me pedagogun e lëndës Dekani në bashkëpunim me përgjegjësin e DFK ngre një komision ad-hok për rivlerësim të provimit. Në përfundim të vlerësimit Komisioni jep vendimin final duke e bërë transparente procesin me studentin dhe pedagogun e lëndës përkatëse. Për këtë program në nuk evidentuam një realizim praktike të tilla. <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentët e programit</i>
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studentëve duke respektuar

	<i>konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimit nga studentët dhe zgjidhjes së saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme kryesisht në fushën e financës dhe kontabilitetit, por edhe të menaxhimit. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike në këto drejtime. Mbështetur në 36 module që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve. <i>Evidenca nr.24.Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr. 5. Rregullorja e programit Bahelor në FK</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë dhe informacionit si dhe shkencat humane. Në programin e studimit përfshihen lëndë të kësaj natyre si “Bazat e Informatikës” dhe “Struktura e të dhënave” që zhvillohen në vitin e parë dhe “Sistemet e Kompjuterizuar në kontabilitet” që zhvillohet në vitin e tretë dhe që është pjesë e fushës së këtij programi. Nga takimi me stafin dhe studentët rezultoi që aftësitë e veçanta në fushën e informacionit e teknologjisë arrihen edhe nëpërmjet trajtimin e rasteve studimore, apo detyrave të kursit si dhe tema të caktuara që zhvillohen në laborator. Ne funksion te këtij qëllimi eshte dhe laborator i informatikës i cili eshte rinovuar tërësisht ne funksion edhe te përmbushjes se rekomandimeve te akreditimit paraardhës. Megjithatë siç edhe kemi theksuar dhe propozuar edhe me lartë përfshirja e lëndëve të reja me fokus të drejtpërdrejtë fushën e teknologjisë dhe informacionit me fokus financat digjitale (si , e-biznesi apo e-banking), do

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. “Q. Staff”, Tiranë
Tel: +355 (04) 227-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	riste me shume këto aftësi që tashme janë bere të domosdoshme. Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 mësimi është realizuar përmes platformave të mirënjohura tashmë si Google classroom, sistemi Tims etj. Për mbarëvajtjen e procesit mësimor në këtë periudhë institucioni hartoi dhe manualin përkatës te mësimin online nëpërmjet platformës Edupage. <i>Evidenca nr.24.Plani mësimor i programit të studimit Bachelor ne FK</i> <i>Evidenca nr. 5. Rregullorja e programit Bahelor në FK</i> <u><i>Evidence nr.66.1.Manuali i mësimdhënies online , platforma Edupage.</i></u>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedojë me pedagogut dhe studentit mbi realizimin e programit të lëndës bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit si dhe orientoreshin këta të fundit për provimin final. <i>Evidenca nr.24.Plani mësimor i programit të studimit Bachelor ne FK</i> <i>Evidenca nr. 5. Rregullorja e programit Bahelor në FK</i> <i>Evidenca nr.26.Syllabuset e programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentet.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikën profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e	Bazuar në dokumentacionin dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit të studimit dhe studentët e këtij programi konstatohet që pedagogë të disa lëndëve realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Në disa raste përgatitja dhe mbrojtja e detyrës së kursit bëhet në laboratorin e informatikës. Një rol të rëndësishëm në formimin praktik të studentëve luan edhe realizimi i praktikës profesionale e cila është mundësuar në drejtimet kryesore që ofron ky program dhe që orientojnë nga paketa e praktikës për programin Bachelor. Institucioni ka të aprovuar dokumentacionin përkatës të praktikës profesionale. Në këtë dokument jepen gjithë modalitetet e realizimit të këtij komponenti të rëndësishëm të programit , si dhe vlerësimi nga studenti i këtij komponenti. <i>Evidenca nr.74. Dokumentet për praktiken profesionale për studentet e programit Bachelor në FK:</i>

shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Evidentim nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentet.			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Institucioni në mënyrë aktive realizon aktivitete në formën e takimeve, leksioneve të hapura me pjesëmarrjen e profesionisteve të fushave përkatëse. Në rang njësie bazë, ne evidentuam kalendarin e aktiviteteve të DFK ku pjesëtarë të stafit akademik parashikonin të realizonin takime trajnimi me studentët dhe profesioniste jashtë institucionit. Në dokumentacionin e aplikimit prezantohet edhe raporti i aktiviteteve dhe trajnimeve profesionale që janë organizuar në institucion. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it evidentohen se gjatë periudhës 2020-2023 janë realizuar një numër takime trajnimi dhe leksione të hapura me personalitete të njohura të fushës së ekonomisë dhe financës. <i>Evidenca nr.95. Aktivitetet e FE te KUL për vitet 2020-2023</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi i studimit Bachelor në FK arrin të përmbushë objektivat e tij duke pajisur studentët me njohuri teorike praktike dhe me aftësi profesionale në fushën e financës, bankës, kontabilitetit dhe auditimit. Përmbajtja e këtij programi u jep mundësi të diplomuarve të kenë një spektër të gjerë punësimi në tregun e punës në sektorin e financës dhe të kontabilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet	Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës kryesisht përmes provimit final apo nëpërmjet një punimi diplome. Kriter për mënyrën e vlerësimit të përmbylljes së programit të studimit është nota mesatare e studentit e cila propozohet çdo vit nga DFK (neni 31 i rregullores së programit). Procedura e mbrojtjes përfundimtare, kriteret e mbrojtjes me provim final

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	apo punim diplome janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit (neni 31), rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë si dhe në vetë rregulloren e KUL. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës si një dokument më vete. Të gjitha procedurat e posaçme lidhur me mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët. <i>Evidenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.14. Udhëzim për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës</i> <i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në FK</i> <i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin, studentet dhe sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	DFK, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës me provim final apo punim e diplome. Për studentët që do përmbyllin studimet me provim final hartohet programi i provimit final me njohuri formuese nga gjithë lëndët, por kryesisht ato në kontabilitet dhe financë. Për studentët që do përmbyllin studimet me punim diplome, pas marrjes së informacionit ata plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në DFK përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. Në ndihmë të studentëve për këtë qëllim organizohet seanca metodologjike në auditor ku jepen udhëzimet përkatëse për përgatitjen e punimit përmbyllës. <i>Evidenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.14. Udhëzim për Përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës .</i> <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me stafin akademik dhe studentet e programit</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë	Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit (neni 31 i rregullores së programit) me 3 deri 5 anëtarë i cili në vlerësimin e punimit të diplomës bazohet në disa kritere kryesore si:

gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	• Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik; • Përdorimi i metodologjisë të punimit; • Originaliteti i punimit; • Dobia e punimit; • Cilësia e të shkruajturit; • Paraqitja teknike; • Cilësia e prezantimit; • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës; GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të programeve të tjera që kanë përfunduar programin, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin. Për studentet që përfundojnë programin e studimit nëpërmjet provimit final vlerësimi nga Komisioni i provimit bazohet në përgjigjet e tyre të pyetjeve të tezës përkatëse si dhe pyetjeve të tjera nga Komisioni. <i>Evidenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.14. Udhëzim për Përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, DFK miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të diplomave gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbylljen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim. Bazuar në numrin e ulët të studentëve që ndjekin studimet në këtë program nuk ka ngarkesë të lartë të stafit në rolin e udhëheqësit të punimit. Nga takimi me studentët e këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të diplomës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të

	dhënave të siguruara. Në rastin e punimeve të diplomës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zërë një peshë të konsiderueshme. <i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit, studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta. <i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në komponentët e vlerësimit të përcaktuara në formularin përkatës dhe të plotësuar nga pedagogu udhëheqës i punimit si dhe vlerësimin nga prezantimi i punimit para tyre bën vlerësimin e punimit të diplomës me notë përfundimtare dhe i bëhet të ditur studentit në fund të seancës së mbrojtjes. Nota përfundimtare del si mesatare e të gjitha vlerësimeve të secilit anëtar të Komisionit të posaçëm. <i>Evidenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.14. Udhëzim për Përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në këtë program që i përket vitit akademik 2023-2024. në rast se studenti kërkon dhe kopje të programit të studimit me përmbajtjen lëndore me kërkesën e tij ai pajiset me këtë dokumentacion brenda afatit të caktuar në rregullore kundrejt pagesës së tarifës. <i>Evidenca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Evidenca nr.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</i> <i>Evidenca nr.82.Formati i Diplomës Bachelor në FK</i> <i>Evidenca nr.83.Modeli suplement i diplomës Bachelor në KF</i> <i>Takim në sekretarinë e institucionit</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit.

të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Shtojca nr. 12. Rregullore e Arkiv Protokollit Takim në sekretarinë e institucionit			
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni ka një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentëve dhe i pajis ata me dokumentacionin e nevojshëm në përfundim të programit. Procesi i përmbylljes së detyrimeve të studentëve bazohet në rregulloren e përgjithshme të KUL dhe rregulloren e vetë programit të studimit. Në mënyrë më të detajuar institucioni ka hartuar edhe udhëzuesin përkatës të përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës. GVJ evidentoi këtë proces edhe nga takimi me stafin akademik të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose	Gjatë 3 viteve të fundit në këtë program studimi janë të angazhuar PAE dhe PAK sipas tabelës së mëposhtme.		
	2021-2022	2022-2023	2023-2024
	(23 PA) 14 PAE 9 PAK	(23 PA) 13 PAE 10 PAK	(25 PA) 13 PAE 12 PAK
	Për vitin akademik 2023-2024, rezulton se, Departamenti i Financë-Kontabilitetit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, ka angazhuar 13 PAE dhe 12 PAK. Duke analizuar përbërjen e stafit akademik të angazhuar në këtë program GVJ vlerëson përmbushjen prej tij të objektivave të programit		



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	bazuar kjo në zhvillimin e lendeve në përputhje me fushën përkatëse ku kemi edhe “specializimin” e secili prej tyre. Anëtarët e stafit akademik që mbulojnë programin e studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” kanë një nivel të lartë kualifikimi dhe fusha formimi akademiko-kërkimore që përputhen si me natyrën ashtu edhe me specifikën e moduleve të programit. Përveç kësaj, diplomat e tyre, përvoja e mëparshme akademike, si dhe angazhimet e tyre gjatë punësimit në Departamentin e Financë-Kontabilitetit, përfshirë hulumtimet dhe botimet e realizuara vitet e fundit, dëshmojnë qartë për specializimin dhe përshtatshmërinë e tyre me këtë program studimi. <i>Evidenca nr.5 Aneks tabelat përmbledhëse tabelat 6.1, 6.2, 6.3. (Evidenca nr. 29: CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet; Tabela 12)</i> <i>(Evidenca nr. 30: Të dhënat për kualifikime kërkim shkencor të stafit për 3 vitet e fundit ; Tabelat nr.19, 20)</i>																				
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, i angazhuar në zbatimin e programit të studimit për vitin akademik 2023-2024, plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Në zhvillimin e këtij programi kanë qenë të angazhuar gjithsej 25 personel akademik me kualifikimet e mëposhtëm: 1 staf akademik me titullin Profesor Doktor, 3 staf akademik me titullin Prof.Asoc. 13 staf akademik me titullin Doktor, 4 Asistent-Lektorë me titullin MSc, të cilët janë në proces doktoreture. 4 personel akademik me titullin MSc Pesha specifike e ngarkesës mësimore të PAE ndaj gjithë ngarkesës në auditor, duke përfshirë praktikën profesionale dhe detyrimin përmbyllës, është 75% (1380/1830), që përputhet me kufirin e lejuar. <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>1830</td><td>1335</td><td>495</td><td>73%/27%</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>1830</td><td>1380</td><td>450</td><td>75.4%/24.6%</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>1830</td><td>1296</td><td>534</td><td>70.8%/29.2.8%</td></tr></table>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2020-2021	1830	1335	495	73%/27%	2021-2022	1830	1380	450	75.4%/24.6%	2022-2023	1830	1296	534	70.8%/29.2.8%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2020-2021	1830	1335	495	73%/27%																	
2021-2022	1830	1380	450	75.4%/24.6%																	
2022-2023	1830	1296	534	70.8%/29.2.8%																	





	Sipas kuadrit ligjor në fuqi, ngarkesa mësimore vjetore e stafit akademik përcaktohet me vendim të Senatit Akademik, duke respektuar standardet e përcaktuara. <i>(Tabela nr 6; Grup Tabelat 12).</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Rezulton se, një menaxhim efikas i burimeve njerëzore sigurohet nga Kolegji Universitar “Logos”, përmes autoriteteve dhe organeve drejtuese, të mbështetura nga koordinimi i vazhdueshëm i Zyrës së Burimeve Njerëzore. Bazuar në dokumentacioni e aplikimit të institucionit por edhe nga vizita në institucion GVI, evidentoi se kjo zyrë ndjek dhe monitoron procedurat e rekrutimit të personelit akademik në bashkëpunim me njësinë bazë dhe atë kryesore, duke respektuar Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrin ligjor në fuqi. GVI shqyrtoi dhe dy dosje të personelit akademik të programit (me zgjedhje të rastësishme) nga ku rezulton se dosjet ishin të plota dhe përmbanin gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Njëkohësisht Zyra e Burimeve Njerëzore bashkëpunon edhe me Zyrën e Arkiv-Protokollit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, marrëdhëniet ndërmjet Kolegjit Universitar “Logos” dhe punëmarrësve rregullohen nga kontrata individuale e punës <i>(Evidenca nr.39)</i>. Kjo kontratë është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përfshirë përshkrimin e detyrimeve, funksioneve dhe proceseve të punës sipas pozicionit dhe funksionit përkatës. Për personelin akademik efektiv, hartohet edhe një Marrëveshje për organizimin kohor të punës, si shtojcë e kontratës, në përputhje me Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS). <i>(Evidenca nr.12:Rregullore Arkiv – Protokolli, Evidenca nr.39:Kontrate individuale e punës për personelin akademik, Evidenca nr. 41: Marrëveshje kohore e punës me evidenca kontrate për stafin akademik të KU “Logos”, Evidenca nr.42: Politika dhe procedura e Burimeve Njerëzore ne Kolegjin Universitar LOGOS.)</i> Sipas <i>(Evidenca nr. 31: Mobilitete të stafit akademik në kuadër të Erasmus +; Evidenca nr. 45: Trajnime nga institucioni për mësimdhënien; Evidenca nr.85-Praktika të mbështetjes financiare të stafit nga Institucioni)</i>, vihet re se Kolegji Universitar “Logos” ka në fokusin e tij, politika integruese të personelit akademik.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme	Në Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit Universitar “LOGOS” janë të përcaktuara procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik. Sipas takimit të realizuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVI) me

dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, procedura ndjek hapat e mëposhtëm: <i>Identifikimi i nevojave:</i> Çdo fillim viti akademik, njësia bazë analizon dhe identifikon nevojat për personel të ri akademik. Pas miratimit nga Dekanati, kërkesa përcillet tek Rektori i Kolegjit Universitar "LOGOS". <i>Formimi i komisionit për rekrutim:</i> Njësia bazë krijon një komision ad-hoc për rekrutimin e personelit, i cili miratohet nga Dekani. Administratori i Institucionit propozon një anëtar nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe pas miratimit përfundimtar nga Rektori, procedurat e rekrutimit koordinohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. <i>Shpallja e vendeve vakante:</i> Vendet vakante të miratuara shpallen publikisht. <i>Procesi i konkurrimit:</i> Organizohen konkurse përmes shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve dhe realizimit të intervistave ballë për ballë. Vlerësimi i kandidatëve kryhet bazuar në një tabelë pikëzimi, ku intervista përfaqëson 40% të vlerës totale. <i>Njoftimi i rezultateve:</i> Pas përfundimit të procesit të konkurrimit, Zyra e Burimeve Njerëzore njofton kandidatët për rezultatet, duke informuar ata që janë shpallur fitues. <i>Marrëdhënia e punës:</i> Marrëdhëniet e punës midis Kolegjit Universitar "LOGOS" dhe stafit rregullohen nga kontrata individuale e punës dhe anekset e saj, të hartuara dhe zbatuara në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar "LOGOS", neni 23 & 24</i> <i>Evidenca nr. 2. Rregullore e përgjithshme e Kolegjit Universitar "LOGOS"</i> <i>Evidenca nr. 42. Politika dhe procedura e Burimeve Njerëzore në KU "Logos"</i> <i>Evidenca nr. 43. Paketë rekrutimi dhe përzgjedhjeje për personel akademik me kohë të plotë</i> <i>Evidencat nr. 39 dhe 40. Kontratë individuale e punës për personelin akademik dhe administrativ</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstatoi se angazhimi i personelit ndihmës në këtë institucion është në nivele minimale, të përshtatura me numrin aktual të studentëve, bazuar kjo në informacionin e paraqitur në Raportin e Vetëvlerësimit (RVB), por edhe nga vizita e realizuar në institucion. Siç edhe e kemi theksuar më lart në nivel institucional janë 2 personel ndihmës akademik që kontribuojnë në mbarëvajtjen e laboratorëve dhe ndihmojnë pedagoget gjatë përdorimit nga studentët të kësaj




laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	infrastruktura.”. Studentët e programit të studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” kanë mundësinë të përdorin laboratorët e vënë në dispozicion për zhvillimin e orëve laboratorike të parashikuara në planin mësimor. Këto orë laboratorike synojnë përvetësimin e aftësive praktike, si komunikimi dhe prezantimi, si dhe zhvillimin e aftësive informatike dhe teknike të domosdoshme për programin e studimit. <i>Evidenca nr. 24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet”.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Zyra e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Zyrën e Arkiv-Protokollit administron, ruan dhe përditëson dokumentacionin e personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Këto zyra janë përgjegjëse edhe për hartimin dhe ndjekjen e procedurave për rekrutimet e reja, si dhe për arkivimin e dosjeve përkatëse të personelit akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Gjithashtu, ato administrojnë marrëveshjet kontraktuale për organizimin kohor të punës së stafit akademik, duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Gjatë procesit të vlerësimit, GVJ shqyrtoi në mënyrë rastësore dosjet personale të dy pedagogëve të përfshirë në programin e studimit (njëri me kohë të plotë dhe tjetri me kontratë). Nga shqyrtimi rezultoi se dosjet ishin të kompletuara me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përfshirë CV-të, kontratat e punës, diplomat, kualifikimet dhe dokumente të tjera relevante. <i>Evidenca nr. 7. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</i> <i>Evidenca nr. 12. Rregullore Arkiv – Protokolli</i> <i>Evidenca nr. 42. Politika dhe procedura të Burimeve Njerëzore në KU “Logos”</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e	Praktika profesionale zhvillohet pranë institucioneve dhe kompanive me të cilat Kolegji Universitar “LOGOS” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Procesi mbikëqyret nga një pedagog i caktuar nga Departamenti, i cili siguron ndjekjen e studentëve sipas një plani të strukturuar. Kjo eksperiencë ndihmon studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike dhe të kontribuojnë në projekte reale me mbështetje dhe rol të përshtatshëm për nivelin e tyre të studimeve. Në përfundim të studimeve, çdo student që ndjek programin Bachelor dhe përmbush kriterin e notës mesatare të përcaktuar nga Departamenti, duhet të përgatisë një mikrotezë për marrjen e diplomës. Puna kërkimore drejtohet nga një udhëheqës shkencor me përvojë akademike veçanërisht në fushat e financës dhe kontabilitetit.




diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<i>Evidenca nr.44: Vendime te Dekanit të Fakultetit Ekonomik për caktimin e Koordinatorëve sipas programit të studimit, Evidenca nr. 74. Dokumentet për praktikën profesionale për studentët e programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"</i> <i>Evidenca nr. 36. Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me IAL brenda dhe jashtë vendit</i> <i>Evidenca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me bizneset</i> <i>Evidenca nr. 38. Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me institucione joarsimore</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktika profesionale zhvillohet pranë Institucioneve dhe kompanive të biznesit me të cilat Kolegji Universitar "LOGOS" ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga Departamenti. GVJ-së iu komunikua, që studentët gjatë gjithë periudhës së praktikës, udhëhiqen nga mbikëqyrësi në vendin e praktikës, i cili i ndihmon në realizimin e saj si dhe bën vlerësimin e tij në përfundim të periudhës së praktikës. <i>Evidenca nr. 74. Dokumentet për praktikën profesionale për studentët e programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: -Departamenti i Financë-Kontabilitetit garanton qëndrueshmëri në personelin akademik, si atë efektiv ashtu edhe atë të angazhuar për këtë program studimi. -Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi plotëson nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësimdhënien në programin Bachelor në Financë-Kontabilitet. -Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat për personelin akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe kontratë. -KU "Logos" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme për realizimin e praktikave profesionale dhe ka hartuar udhëzues për zbatimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale dhe temës së diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstaton, bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në Kolegjin Universitar “Logos” si më poshtë: Programi i studimit “Bachelor në Financë-Kontabilitet” zhvillon procesin mësimor në Kampusin Nr. 1 të Kolegjit Universitar “Logos”, i cili ndodhet në adresën: Rruga “Dritan Hoxha”, Pallatet “Komfort”, Tiranë. Hapësirat e kampusit përfshijnë një sipërfaqe prej 5931 m², të përdorur bazuar në një Kontratë Huapërdorjeje të Pasurisë së Paluajtshme të lidhur me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Për nevojat e këtij programi studimi, janë në dispozicion: -Dy salla leksionesh në katin e pestë, -Një sallë në katin e nëntë, -Laboratori i informatikës në katin e katërt, -Një laborator i digjitalizuar në katin e gjashtë, i ndërtuar rishtazi në kuadër të projektit Homo Digitalis, ku KU “Logos” është partner, -Qendra e Inovacionit dhe Sipërmarrjes në katin e tetë, ndërtuar rishtazi në kuadër të projektit Oasis, ku KU “Logos” është gjithashtu partner. GVJ vlerëson se mjediset e këtij kampusi janë të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për të siguruar zhvillimin e një procesi mësimor cilësor. Gjatë inspektimit të kryer, GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, bibliotekën dhe mjedise të tjera në përdorim të përbashkët, duke konstatuar se këto mjedise janë pajisur me teknologji elektronike dhe digjitale, të cilat mundësojnë realizimin efikas të mësimdhënies, si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Dokumentacioni i shqyrtuar vërteton se objekti është ndërtuar me materiale cilësore dhe përmbush standardet e sigurisë në punë dhe mirëqenien e stafit dhe studentëve. <i>Evidenca nr. 46. Tabela e godinave të Kampusit</i> <i>Evidenca nr. 47. Inspektim Teknik</i> <i>Evidenca nr. 48. Relacion mbi infrastrukturën</i> <i>Evidenca nr. 49. Leje Higjieno-Sanitare</i> <i>Evidenca nr. 50. Kontratë Mbrojtja në punë</i> <i>Evidenca nr. 52: Trajnim, Certifikim për mbrojtje ndaj zjarrit, Plan evakuimi kampusi 1</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Evidenca nr. 53: Procesverbal inspektimi; Evidenca nr. 54: Raport Analizë e treguesve fiziko – kimikë).</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës, GVJ inspektoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, bibliotekën, si dhe mjedise të tjera në përdorim të përbashkët. U konstatua se këto mjedise, në përputhje me funksionet e tyre, janë pajisur me mjete elektronike dhe digjitale, duke siguruar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik në nivelin më të lartë të mundshëm. GVJ vlerëson se mjediset e kësaj ndërtese janë të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për të mundësuar një proces mësimor cilësor. <i>Evidenca: Vizita në institucion.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ pas shqyrtimit të planit mësimor konstatoi se, programi i studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” përmban kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe përfshin realizimin e orëve të detyrueshme laboratorike. Rezulton se, për të mbështetur nevojat e këtij programi dhe të Fakultetit Ekonomik, në dispozicion janë: Laboratori i informatikës, i vendosur në katin e katërt të kampusit, një nga tre laboratorët e informatikës që disponon Kampusi Nr. 1. Një laborator i digjitalizuar, ndërtuar rishtazi në kuadër të projektit Homo Digitalis, në të cilin KU “Logos” është partner, i pozicionuar në katin e gjashtë. Qendra e Inovacionit dhe Sipërmarrjes, e ndërtuar rishtazi në kuadër të projektit Oasis Digitalis, ku KU “Logos” është gjithashtu partner, e vendosur në katin e tetë. Të gjitha këto ambiente janë të pajisura me programet e duhura që mundësojnë dhe lehtësojnë zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me standardet bashkëkohore. Gjithashtu, rezulton se, biblioteka e Kampusit Nr. 1 ka pësuar një riorganizim dhe rikonstruksion të plotë në fund të vitit 2019. Me një sipërfaqe prej 173 m², biblioteka ofron: 40 poste leximi, 18 poste të pajisura me kompjuter. Këto mundësojnë akses në bibliotekën digjitale dhe ofrojnë burimet e nevojshme për studentët, duke mbështetur përgatitjen e detyrave të kursit dhe realizimin e temave të diplomës. <i>Evidenca nr.46: Tabela e godinave të Kampuseve</i>

	<i>Evidenca nr. 48: Relacion mbi infrastrukturën, Tabela 16 , Vizita në institucion.</i> <i>Evidencë nr.55: Praktika për zgjerimin e infrastrukturës</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ konstatoi se, në funksion të programeve të studimit të Fakultetit Ekonomik, rezulton: -laboratori i informatikës në katin e katërt të kampusit (nga tre laboratorë të informatikës që ka kampusi 1, në të cilin organizohet lënda sisteme të kompjuterizuara në kontabilitet, -një laborator i digjitalizuar në katin e gjashtë, i ndërtuar rishtazi në kuadër të projektit Homo Digitalis në të cilin KU Logos është partner, -Qendra e Inovacionit dhe Sipërmarrjes në katin e tetë, (ndërtuar rishtazi në kuader të projektit Oasis Digitalis në të cilin KU Logos është partner), të pajisur me programet e duhura që mundësojnë dhe lehtësojnë procesin mësimor. <i>Tabela 16, Tabela 17,</i> <i>Evidenca nr.75:Projektet ne te cilat është partner KU Logos.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>- Klasat e leksioneve dhe të seminareve, si dhe ambientet e tjera, janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e domosdoshme për të siguruar një proces mësimor bashkëkohor.</i> <i>- Në dispozicion të studentëve janë dy laboratorë informatike dhe ambiente të tjera të përbashkëta, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për mbështetjen e procesit të tyre mësimor.</i> <i>-KU "Logos" disponon ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të	GVJ konstaton, bazuar në programet e lëndëve të përfshira në programin e studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet", si vijon: <i>Përshtatshmëri e literaturës:</i> Titujt e përfshirë në literaturën bazë dhe ndihmëse janë në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe u ofrojnë studentëve njohuritë e nevojshme të parashikuara në kurrikul. Literatura bazë përbëhet nga tekste

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	në gjuhën shqipe, përfshirë autorë shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. <i>Rishikim i literaturës:</i> Në fillim të çdo viti akademik, personeli akademik rishikon dhe përditëson syllabuset e lëndëve. Çdo departament përgatit propozime për librat e nevojshëm që duhet të shtohen në fondin e bibliotekës. <i>Pasurim të bibliotekës:</i> Biblioteka e Kolegjit Universitar “Logos” është pajisur me literaturë bazë dhe ndihmëse, sipas kërkesave të departamenteve përkatëse, duke përfshirë libra në gjuhën shqipe dhe të huaj. Kjo literaturë është e aksesueshme për studentët dhe mbështet procesin mësimor, duke plotësuar nevojat për leksione, seminare dhe laboratorë për çdo lëndë në kurikulum. <i>Prioritetet për 2020-2023:</i> Gjatë periudhës 2020-2023, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka pasur si prioritet pasurimin e bibliotekës fizike dhe online me tituj të rinj dhe bashkëkohorë. <i>Shfrytëzim i bibliotekave online:</i> Procesi mësimor online ka ndihmuar në zgjerimin e aksesit në literaturë përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Kjo ka lehtësuar përdorimin e bibliotekave online nga pedagogët dhe studentët, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e procesit mësimor. GVJ vlerëson se këto masa dhe burime garantojnë një standard të lartë në literaturën e ofruar, duke i mundësuar studentëve të zhvillojnë kompetencat e kërkuara nga programi i studimit. <i>Evidenca nr. 59. Lista e titujve në bibliotekë për Fakultetin Ekonomik</i> <i>Evidenca nr. 24. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet”</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë takimeve në lidhje me procesin e riakreditimit të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, GVJ-së iu bë me dije se, në fillim të çdo viti akademik, secili anëtar i stafit akademik i paraqet përgjegjësit të njësisë bazë një kërkesë që përmban titujt e përditësuar të literaturës bazë dhe ndihmëse për zhvillimin e procesit mësimor, sipas lëndëve përkatëse. Më pas, përgjegjësi i njësisë bazë ia përcjell këtë kërkesë koordinatores së bibliotekës, e cila vijon me procesin e pasurimit të bibliotekës me titujt e rinj të propozuar, duke siguruar përditësimin dhe përshtatjen e fondit të literaturës me nevojat aktuale të programeve të studimit. <i>Evidenca nr. 60. Kërkesa e Departamentit Financë-Kontabilitet drejtuar Bibliotekës për tituj të rinj</i>




Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstaton se biblioteka e Kolegjit Universitar “Logos” është e pasur me literaturë fizike në shqip dhe gjuhë të huaj, e cila mbulon disiplinat e nevojshme për programin “Bachelor në Financë-Kontabilitet” dhe për programe të tjera studimi. Biblioteka e Kampusit Nr. 1, me një sipërfaqe prej 173 m², është rikonstruktuar dhe riorganizuar në fund të vitit 2019. Ajo përmban: 40 poste leximi 18 poste të pajisura me kompjuter. Në kuadër edhe të verifikimit të plotësimit të rekomandimeve të dhëna nga akreditimi i mëparshëm GVJ evidentoi që biblioteka e KUL gjatë viteve të fundit është pasuruar me një literaturë të bollshme në fushën e financë kontabilitetit. Këtu përfshihen tekste në gjuhë të huaj dhe shqipe (64 tituj në fushën e ekonomisë) që mbulojnë lëndë të fushës së financë kontabilitetit, revista periodike si dhe cikle leksionesh për lëndët e programit.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjithashtu, evidentuam edhe përdorimin e literaturës në versionin elektronik (PLEIADES) si dhe aksesin online të bibliotekave JSTORE dhe EBSCO si një alternative bashkëkohore për studentët në shfrytëzimin e literaturës. Këto mundësojnë akses në materiale digjitale dhe shërbime të tjera mbështetëse për studentët dhe stafin akademik. Gjithashtu, GVJ-së iu komunikua që Kolegji Universitar “Logos” ofron akses në literaturën online të bibliotekës së Universitetit të Pireut, nëpërmjet bashkëpunimit me këtë institucion, duke shfrytëzuar platformën: http://lib.unipi.gr/. Kjo mundësi zgjeron gamën e burimeve akademike të disponueshme për studentët dhe pedagogët. <i>Evidenca nr. 59. Lista e titujve në bibliotekë për Fakultetin Ekonomik</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion pati ndërmjet të tjerësh, takim me studentët e programit Bachelor në “Financë-Kontabilitet”, të cilët konfirmuan se kanë akses pa pagesë në literaturën fizike të disponueshme në bibliotekën e Kolegjit Universitar “Logos” si dhe në bibliotekën elektronike, e cila është e aksesueshme në ambientet e institucionit. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, Kolegji Universitar “Logos” ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik një sërë

	platformash të bibliotekave elektronike si Questia, JSTOR dhe EBSCO, të cilat ofrojnë literaturë të pasur akademike dhe shkencore. Gjithashtu, u konfirmua se Kolegji Universitar “Logos” ofron akses edhe në literaturën online të bibliotekës së Universitetit të Pireut, falë marrëveshjes së bashkëpunimit me këtë institucion akademik. Kjo mundësi rrit gamën e burimeve akademike që studentët dhe stafi mund të shfrytëzojnë për studimet dhe kërkimet e tyre. <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e kampusit ku zhvillohet mësimi për programin e studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet”, është në dispozicion të studentëve të këtij programi dhe jo vetëm. Ajo ka 18 poste të pajisura me kompjuter dhe akses në internet, nga ku studentët mund të kërkojnë literaturë të ndryshme për studimet dhe kërkimet e tyre. Nga vizita në Institucion, përgjegjësjë për bibliotekën në Kampin Kryesor të KU Logos, i komunikoi GVI-së, se biblioteka përdor programin e katalogimit të përbashkët elektronik PLEIADES, i bazuar në standardin MARC 21. Ky sistem mundëson që fondi i bibliotekës të paraqitet në bazën e të dhënave elektronike, duke ofruar një katalog elektronik të aksesueshëm për të gjithë përdoruesit. Katalogu elektronik mund të konsultohet përmes linkut: http://lib-orthodoxalbania.org, duke mundësuar kërkimin dhe gjetjen e informacionit që disponon fondi i bibliotekës për studentët dhe stafin akademik. <i>Tabela 17, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf, Vizita në institucion. Vizita në institucion</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Sipas vizitës në bibliotekë, ajo është e hapur për frekuentim gjatë gjithë vitit, përveç ditëve të festave zyrtare, nga e hëna në të premte, me orar 08:00 deri në 20:00. Studentët kanë mundësinë të anëtarësohen në bibliotekë dhe të përdorin literaturën fizike dhe elektronike në mjediset e bibliotekës. Po ashtu, ata mund të huazojnë literaturën që u nevojitet dhe ta përdorin jashtë mjedisëve të bibliotekës, duke u mundësuar kështu akses të mëtejshëm dhe fleksibilitet për studimet e tyre. <i>Evidenca nr. 8 Rregullore e Bibliotekës</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf</i> <i>Vizita në institucion</i>

Kriteri 8. Biblioteka dhe njësité përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ-së iu komunikua se, në fillim të çdo viti akademik, çdo anëtar i stafit akademik paraqet një kërkesë për titujt e përditësuar të literaturës bazë dhe ndihmëse për realizimin e procesit mësimor sipas lëndëve përkatëse. Kjo kërkesë, pas miratimit nga përgjegjësi i njësisë bazë, drejtohet te koordinatori i bibliotekës për t'u siguruar që bibliotekës t'i shtohen titujt e rinj që përmbushin kërkesat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur, u konstatua se fondi i Bibliotekës së Kolegjit Universitar "LOGOS" përfshin një koleksion të pasur materialesh, në gjuhën shqipe dhe të huaj, i mbushur përmes blerjeve, shkëmbimeve, dhuratave dhe abonimeve. Biblioteka ka një strategji të shkruar për përditësimin e fondit të saj, e cila siguron që materiali i disponueshëm të përditësohet dhe të pasurohet me tituj të rinj dhe të nevojshëm. Pjesë e kësaj strategjie është edhe zgjerimi i marrëveshjeve me universitete perëndimore për të mundësuar akses në bibliotekat e tyre digjitale. Ky veprim ka si qëllim përmbushjen sa më cilësore të nevojave për programin Bachelor në "Financë Kontabilitet" dhe për të gjithë programet e tjera të studimit që ofron Kolegji Universitar "LOGOS". Gjithashtu, biblioteka ofron tekste shkollore për studentët, duke siguruar mundësitë për studime të thelluara. <i>Evidenca nr.36:Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me IAL brenda dhe jashtë vendit</i> <i>Evidenca nr.59:Lista e titujve ne biblioteke per Fakultetin Ekonomik,</i> <i>Evidenca nr. 60. Kërkesa e Departamentit Financë-Kontabilitet drejtuar Bibliotekës për tituj të rinj, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf,</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>Evidenca nr. 62. Strategjia e bibliotekës 2019-2023</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: -Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodimin dhe shfrytëzimin e saj në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të Kolegjit Universitar "LOGOS". Kjo infrastrukturë përfshin ambiente moderne dhe mundësi të shfrytëzimit të literaturës dhe burimeve të tjera akademike që mbështesin procesin mësimor. -Literatura bazë dhe ndihmëse e programit të studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" përmbush objektivat e tij të studimit dhe u mundëson studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe nga vizita në institucion GVJ evidentoi se Kolegji Universitar “Logos mundëson infrastrukturë elektronike të nevojshme, e cila përfshin platforma të ndryshme online që lehtësojnë dhe mbështesin komunikimin ndërmjet stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve të programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”. GVJ asistoi edhe në një demonstrim konkret të këtij sistemi. Gjithashtu, rezultoi se Zyra e IT-së është e angazhuar për ruajtjen e sigurtë dhe afatgjatë të të dhënave dhe zbatimin e një plani rikuperimi. Po kështu, Kolegji Universitar “LOGOS” përdor sistemin Edupage për menaxhimin e informacionit dhe vlerësimin e studentëve. Ky sistem ndërtohet dhe reflekton vlerësimet në bazë të kategorive të pikëve të specifikuar në syllabuset e lëndëve. Studentët mund të aksesojnë vlerësimet në kohë reale dhe në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre. Gjithashtu, kopje të këtyre të dhënave ruhen si backup në formatin xlsx dhe shpërndahen në kompjuterët lokalë dhe në cloud, për t’u siguruar që informacioni është i ruajtur në mënyrë të sigurtë dhe mund të rikuperohet në çdo moment. Po kështu nga vizita në Sekretarinë mësimore të Fakultetit Ekonomik, rezultoi se ajo me ndihmën e sistemit Edupage, gjeneron dhe ruan statistika vjetore për disa aspekte të rëndësishme, si: -Numri i regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; -Të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet; -Të dhëna për numrin e studentëve të secilit vit akademik; -Të dhëna për ecurinë akademike të studentëve; -Numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik; -Të dhëna për studentët që diplomohen, etj. <i>Evidenca nr. 63: Manual i përdorimit të Platformës Edupage(pedagogë-studentë)</i> <i>Evidenca nr. 64: Procedurat fillestare të një sistemi sigurie, shpërndarjeje të dokumentacionit të institucionit, Kopje Sigurie në Google Drive</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se Kolegji Universitar “LOGOS” ka një sistem efikas të informimit që ndihmon në menaxhimin dhe shpërndarjen e informacionit brenda institucionit. Ky informacion është i kategorizuar në dy drejtime: -Informacion të hapur për publikun, që është i aksesueshëm nga çdo palë e interesuar jashtë institucionit. -Informacion të brendshëm, i cili shpërndahet sipas funksionit dhe nevojës tek organet e institucionit, zyrat përkatëse dhe studentët. Për informacionin e brendshëm, Edupage përdoret nga studentët, stafi akademik dhe sekretaria mësimore. Ky sistem është i implementuar për të mundësuar komunikimin të shpejtë dhe të sigurtë, duke siguruar që informacioni të shpërndahet menjëherë dhe në mënyrë efikase ndërmjet pjesëtarëve të institucionit. Një rol kyç në administrimin dhe menaxhimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ e luan Zyra e Burimeve Njerëzore dhe arkiv-protokollit, që siguron ruajtjen e të dhënave dhe procese administrative të përditësuara dhe të strukturuar. <i>Evidenca nr.12: Rregullore Arkiv – Protokolli,</i> <i>Evidenca nr.42: Politika dhe procedura te burimeve njerëzore,</i> <i>Evidenca nr.64: Procedurat fillestare të një sistemi sigurie _shpërndarjeje të dokumentacionit të institucionit_Kopje Sigurie në Google Drive.</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar “Logos” përdor në mënyrë aktive paketën Microsoft Office 365 Academic, e cila mbështet bazën e të dhënave dhe sistemin Microsoft Teams. Ky sistem ofron mundësinë për arkivimin e leksioneve, detyrave, provimeve dhe çdo forme tjetër komunikimi ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Sipas takimit me stafin akademik, u vlerësua se Microsoft Teams ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë periudhës së mësimin online dhe vazhdon të kontribuojë në garantimin e ecurisë së procesit mësimor dhe në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, sekretaria mësimore e Kolegjit Universitar “Logos” mban të dhëna personale të studentëve, përfshirë numrat e telefonit, adresat e email-it dhe ruan kontakte të vazhdueshme me studentët për njoftime dhe informacion të rëndësishëm. Kjo bëhet në përputhje me rregulloren e posaçme për ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave personale, duke siguruar mbrojtjen dhe trajtimin e informacionit të studentëve në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.



	<i>Evidenca nr.7:Rregullore për mbrojtjen, përpunimin ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, Evidenca nr. 65: Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies</i> <i>Evidenca nr. 66: Manuali i mësimdhënies online</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstaton se Edupage dhe Microsoft 365, ofrojnë mundësinë për monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ në Kolegjin Universitar “Logos”. Microsoft Teams përdoret për të ruajtur dhe shpërndarë të gjithë materialin mësimor, përfshirë leksionet e zhvilluara, detyrat e studentëve dhe burime të tjera të nevojshme për mësim. Kjo platformë lehtëson raportimin në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët, duke mundësuar një mbikëqyrje të efektshme të procesit mësimor dhe administrativ. GVJ-së iu komunikua se të gjitha të dhënat dhe statistikak që mbliiden përmes këtyre platformave janë të disponueshme vetëm për llogaritë e administratorëve të sistemit dhe llogaritë e tjera të autorizuar, duke siguruar mbrojtjen dhe privatësinë e informacionit. <i>Evidenca nr.7:Rregullore për mbrojtjen, përpunimin ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, Evidenca nr. 63: Manual i përdorimit të Platformës Edupage(pedagogë-studentë), Evidenca nr.66.2:Manual i mesimdhënies online- Office 365</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstaton se Kolegji Universitar “LOGOS” ka një faqe zyrtare interneti (http://www.kulogos.edu.al) e cila është e disponueshme në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Kjo faqe ofron informacion të hapur për publikun dhe çdo subjekt të interesuar, duke përfshirë të dhëna të rëndësishme mbi strukturën organizative, veprimtaritë akademiko-shkencore dhe sociale, si dhe bazën ligjore të funksionimit të Kolegjit. Gjithashtu, në këtë faqe janë publikuar informacione të tjera në lidhje me ofertën akademike, kriteret e pranimit, përmbajtjen e programeve të studimit, informacion mbi stafin akademik sipas departamenteve dhe fakulteteve, orari i mësimit dhe provimeve, si dhe njoftime për aktivitete të ndryshme akademike dhe sociale. http://www.kulogos.edu.al
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>-Zyra e IT-së angazhohet për ruajtjen e sigurtë dhe afatgjatë të të dhënave, si dhe për zbatimin e një plani të detajuar rikuperimi, për të siguruar vazhdimësinë dhe integritetin e të dhënave.</i> <i>-Kolegji Universitar “Logos” mundëson infrastrukturën elektronike përmes platformave Edupage dhe Microsoft 365,</i>

	të cilat janë të aksesueshme lehtësisht online dhe sigurojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" harton buxhetin në përputhje me politikat e përgjithshme të zhvillimit dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. -Buxheti i Kolegjit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, duke reflektuar nevojat e institucionit dhe kërkesat e njësive bazë dhe kryesore. -Kolegji Universitar "LOGOS" siguron të ardhura të mjaftueshme, përveç fondeve nga tarifat e studentëve dhe projektet e partneritetet, përmes donacioneve që mbledh përmes Fondacionit "Logos". Kjo strukturë financiare e bën Kolegjin të qëndrueshëm financiarisht, duke mundësuar zhvillimin e vazhdueshëm dhe mbështetje për programet dhe aktivitetet e tij. <i>Evidenca nr.1: Statuti i KU "LOGOS",</i> <i>Evidenca nr.2: Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS,</i> <i>Evidenca nr.15: Plani Strategjik i Kolegjit Universitar Logos 2018-2024</i> <i>Evidenca nr. 67: Sugjerimet e njësive bazë mbi përpilimin e Projekt-Buxhetit</i> <i>Evidenca nr. 68: Projektbuxheti 2020-2023</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe	GVJ konstaton se: -Plani i financimit i Kolegji Universitar "LOGOS" hartohet në rang institucional dhe përfshin financimin për burimet njerëzore për të gjithë programet e studimit, shërbimet operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, si dhe shpenzimet për bibliotekën, bursa dhe studime, si dhe detyrimet financiare dhe grantet për projektet ku KU "LOGOS" është pjesëmarrës. -Kolegji mbulon kostot për sigurimin e burimeve njerëzore, infrastrukturës dhe siguron fonde për mbulimin e shpenzimeve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimn. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	operative, duke siguruar kështu zhvillimin normal të procesit mësimor dhe përmbushjen e standardeve akademike. <i>Evidenca nr.1: Statuti i KU "LOGOS", Evidenca nr.2: Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Evidenca nr.15: Plani Strategjik i Kolegjit Universitar Logos 2018-2024, Evidenca nr.31: Mobilitete të stafit akademik dhe studenteve në kuader të Erasmus+, Evidenca nr.45: Trajnime nga institucioni për mësimdhënien, Evidenca nr. 67: Sugjerimet e njëjësive bazë mbi përpilimin e Projekt-Buxhetit,, Evidenca nr. 68: Projektbuxheti 2020-2024, Evidenca nr.75: Projektet në të cilat është partner KU Logos, Evidenca nr.85: Praktika të mbështetjes financiare të stafit nga Institucioni, Evidenca nr.101: Financimi i veprimtarive të propozuara nga Këshilli Studentor, Evidenca nr.106: Bursat e akorduara në programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet për vitet 2020-2023, Evidenca nr.112: Trajnime të stafit akademik organizuar për sigurinë e cilësisë në mësimdhënie</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ konstaton se: -Bordi Drejtues i Fondacionit përcakton dhe përzgjedh një Ekspert Kontabël të Autorizuar për realizimin e auditimit të jashtëm të institucionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe pasqyrave financiare dhe në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Nr. 80/2015 dhe kuadrin rregullativ të brendshëm të institucionit. -Raporti i Auditimit për vitet 2020, 2021 dhe 2022 është depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, bashkë me pasqyrat financiare të përgatitura nga Eksperti i Pavarur Kontabël. -Raporti i veprimtarisë financiare është pjesë e raportit vjetor të aktivitetit të institucionit dhe përpilohet e miratohet me pjesëmarrje të stafit akademik. <i>Evidenca nr.1: Statuti i KU "LOGOS", Evidenca nr.2: Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Evidenca nr.21: Raporti vjetor i KU "LOGOS" për vitin akademik 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023. Evidenca nr.22: Raporti Vjetor i Fakultetit Ekonomik për vitin akademik 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023. Evidenca nr.69- Raporti i Auditimit për vitet 2020, 2021, 2022, Evidenca nr.13- Rregullore e Zyrës së Financës, Evidenca nr. 67: Sugjerimet e njëjësive bazë mbi përpilimin e Projekt-Buxhetit, Evidenca nr. 68: Projektbuxheti 2020-2024, Evidenca nr. 69. Raporti i auditit për vitet 2021, 2022,</i>

Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ konstaton se: -Institucioni monitoron qëndrueshmërinë financiare dhe siguron transparencën e menaxhimit të burimeve financiare, duke ndjekur periodikisht realizimin e buxhetit dhe duke dokumentuar raportet financiare të viteve të kaluara. <i>Evidenca nr.1: Statuti i KU "LOGOS", Evidenca nr.2:Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Evidenca nr.13- Rregullore e Zyrës së Financës, Evidenca nr. 67: Sugjerimet e njësive bazë mbi përpilimin e Projekt-Buxhetit,, Evidenca nr. 68: Projektbuxheti 2020-2024, Evidenca nr.69- Raporti i Auditimit per vitet 2020,2021,2022, Evidenca nr.21.1, 21.2 dhe 21.3 Raporti vjetor i KUL per vitet 2021,2022 dhe 2023 (pjesa e Buxhetit)</i> <i>Evidenca nr.22.1, 22.2 dhe 22.3 Raporti vjetor i FE per vitet 2021,2022 dhe 2023 (pjesa e Buxhetit)</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar "LOGOS" për vetë veçorinë e tij si pjesë e Fondacionit "Logos", i cili ka si themelues Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, e cila mbështet dhe inkurajon funksionimin e institucionit në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe edukative ka pasur vazhdimisht qëndrueshmërinë financiare. Kjo është dhe një veçori por para së gjithash një avantazh për këtë institucion krahasueshmërisht me institucionet e tjera të arsimit të lartë jopublik që janë "nën presionin" financiar të ardhurave nga studentët. Burimet e të ardhurave të Institucionit përfshijnë: -Financimi nga Fondacioni Logos; -Të ardhurat nga tarifat e studimit të studentëve; -Financime dhe donacione të tjera si partner në disa projekte të BE-së. Në aktin e themelimit dhe statutin e Fondacionit "LOGOS" përcaktohet qartë karakteri edukativo-mësimor dhe jofitimprurës i tij, i cili pasqyrohet në: -Tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit; -Akordimin e bursave të studimit dhe ndihmave studentëve në nevojë; -Ndarjen në këste të pagesës vjetore, për të lehtësuar ngarkesën ekonomike të studentëve; Rezulton se, në periudhën e pandemisë, Kolegji Universitar "LOGOS" siguroi qëndrueshmëri financiare dhe përdori mbështetje financiare nga Fondacioni për: -Likuidimin e plotë dhe në kohë të pagave për personelin akademik dhe administrativ;

	-Përballimin e shpenzimeve për ngritjen e klasave virtuale, të pajisura me teknologjinë e nevojshme për mësimdhënie cilësore -Mbështetje financiare për studentët në nevojë, për mjete dhe akses në internet. <i>Evidenca nr.21: Raporti vjetor i KU "LOGOS" për vitin akademik 2020-2021, Evidenca nr.22: Raporti Vjetor i Fakultetit Ekonomik për vitin akademik 2020-2021, Evidenca nr.75:Projektet në të cilat është partner KU Logos, Evidenca nr.85:Praktika të mbështetjes financiare të stafit nga Institucioni, Evidenca nr.101:Financimi i veprimtarive të propozuara nga Këshilli Studentor, Evidenca nr.106: Bursat e akorduara në programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet për vitet 2020-2023.</i> <i>Evidenca nr. 69: Raport i Auditimit 2020, 2021, 2022</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" garanton qëndrueshmëri financiare për të mbështetur aktivitetet e tij akademike dhe operacionale. -Kolegji Universitar "LOGOS" harton buxhetin në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me politikat e përgjithshme të zhvillimit. -KU "LOGOS", përveç fondeve që arkëton nga tarifat e studentëve dhe pjesëmarrjes në projekte, siguron të ardhura të mjaftueshme në formën e donacioneve nëpërmjet Fondacionit "LOGOS". -Fondet që krijohen nga të ardhurat e studentëve dhe projekteve mundësojnë ndërmarrjen e veprimeve në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, duke siguruar transparencë të plotë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë qim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: 355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ, bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion konstaton se: -Pranimi i studentëve në ciklin e parë të studimeve "Bachelor në Financë Kontabilitet" bëhet në përputhje me kriteret e pranimit të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015, si dhe në Statutin, Rregulloren e përgjithshme të Kolegjit Universitar "LOGOS", dhe rregulloren e programit "Bachelor në Financë Kontabilitet". -Departamenti Financë Kontabilitet, kryen listimin e kandidatëve sipas kriterit të notës mesatare të arsimit të mesëm të lartë, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përzgjedh kandidatët fitues në përputhje me kuotat e miratuara. -Kolegji Universitar "LOGOS" ndjek të gjitha procedurat dhe kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të Ministrisë dhe agjencive kompetente në varësi të saj (QSHA, RASH) gjatë procesit të pranimit. <i>Evidenca nr. 70. -Vendim per kriteret e pranimit ne programet e studimit qe ofron KU Logos</i> <i>Evidenca nr. 71.-Renditja e aplikanteve fitues ne programin e studimit Bachelor Finance Kontabilitet</i> <i>Evidenca nr.5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se: -Barazia dhe shanset e barabarta janë parime të parashikuara për studentët e përzgjedhur gjatë dhe pas studimeve të tyre, sipas Nenit 10 të Rregullores së Kolegjit Universitar "LOGOS", bazuar në të cilin, personeli i Kolegjit Universitar "LOGOS" gjatë kryerjes së detyrave të tij nuk mund të bëjë diskriminime mbi baza etnike, gjuhësore, racore, politike, mendimi, filozofike, dhe fetare. GVJ lidhur me këtë kriter evidentoi se në përzgjedhjen e stafit akademik si dhe në pranimin e studentëve në këtë program nuk është parë si përparësi baza etnike apo fetare, si një institucion ku një pjesë të financimit realizohet nga Fondacioni Logos ku themelues është Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare. -Informacioni është transparent dhe është i aksesueshëm për publikun në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar "LOGOS" (www.kulogos.edu.al).

	-Departamenti Financë Kontabilitet rishikon herë pas here politikat e pranimit të studentëve në programin e studimit "Bachelor në Financë Kontabilitet", duke siguruar që studentët të informohen vazhdimisht për përmbajtjen dhe formën e programit, metodat e vlerësimit, si dhe afatin e përfundimit të studimeve deri në diplomimin e tyre. <i>Evidenca Nr. 2 Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Neni 10,</i> <i>Evidenca Nr. 87.-Leksione te hapura Kolegji Universitar Logos,</i> <i>Evidenca Nr.88.- Mjetet e komunikimit me studentët,</i> <i>Evidenca Nr.89.- Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU "LOGOS" në shqip,</i> <i>Evidenca Nr. 90.- Pranimi i studentëve të rinj- aktivitetet,</i> <i>Evidenca Nr. 92.- Open Days, Evidenca Nr.94.- Pjesëmarrja në Panaiet e Punës.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ konstaton se: -KU "Logos" ofron informacion të detajuar për kandidatët për studentë lidhur me kriteret, procedurat e pranimit dhe procesin e transferimeve të studimeve, informacion ky që bëhet publik në mjediset e institucionit dhe në faqen elektronike zyrtare. -Kriteret për pranimin në programin e studimit "Bachelor në Financë Kontabilitet" përfshijnë: diplomë të arsimit të mesëm të lartë, ose një diplomë tjetër të fituar jashtë vendit të vlerësuar ekuivalente me diplomën e maturës shtetërore dhe përmbushjen e kriterit të notës mesatare. -Kolegji Universitar "LOGOS" përdor një larmi mjetesh informimi për të komunikuar me publikun lidhur me kriteret dhe procedurat e pranimit dhe transferimit, ku përfshihen: faqja zyrtare e institucionit, fletëpalosje, leksione të hapura, lojra interaktive në disiplinat ekonomike, broshura informative, ditë informimi dhe këshillimi të karrierës, ditë të hapura dhe ditë karriere. <i>Evidenca Nr. 87.- Leksione të Hapura KU Logos, Evidenca Nr. 88.-Mjetet e komunikimit me studentët, Evidenca Nr. 89.- Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU "LOGOS" në shqip, Evidenca Nr. 90.- Pranimi i studentëve të rinj, aktivitetet, Evidenca Nr. 92.- Open Days.</i> <i>Evidenca Nr. 93.- Rrjetet sociale, Evidenca Nr. 65.- Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies.</i>

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstaton se: -Fakulteti Ekonomik i KU "LOGOS", ashtu si dhe vetë institucioni, ofrojnë mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve brenda të njëjtit cikël studimesh, ndërmjet programeve të të njëjtit cikël dhe në fusha studimi të njëjta ose të ngjashme, vetëm në fillim të vitit akademik. -Një komision ad-hoc i ngritur nga Departamenti Financë Kontabilitet pranë Fakultetit Ekonomik, merr vendime për njohjen e krediteve të fituara në institucione të tjera, bazuar në kriteret të përcaktuara dhe kuota të miratuara për secilin program studimi. -Pranimi i studentëve bëhet në përputhje me aktet rregullatore të Ministrisë së Arsimit dhe agjencive kompetente (QSHA, RASH) dhe informacioni për këto kriteret dhe kuota është i disponueshëm në faqen zyrtare të institucionit. <i>Evidenca nr 5 Rregullore e programit te studimit Bachelor në FK (neni 28),</i> <i>Evidenca nr.76: Vendimet e Dekanatit per ngritjen e komisionit per transferimet FE,</i> <i>Evidenca nr.77: Udhezim (Rregullore) e Transferimeve,</i> <i>Evidenca nr.78:Template me të dhëna aplikantësh për transferim studimesh.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" bën publike kriteret e secilit program studimi përpara fillimit të çdo viti akademik, në faqen e tij të web-it dhe në rrjetet sociale, duke përdorur gjithashtu kanale të tjera informuese si Panairret Work & Study, fletëpalosje, programe radiofonike, lajmërimi televizive dhe takime të hapura. -Kriteret e pranimit janë të lehta për t'u aksesuar dhe janë të disponueshme për të gjithë kandidatët për studentë, duke garantuar transparencë në procesin e pranimit. -Kolegji Universitar "LOGOS", organizon vizita informuese në ambientet e tij mbi ofertën akademike, programet e studimit, mundësitë e punësimit, praktikat profesionale, bashkëpunimet me institucione brenda dhe jashtë vendit, përfshirë mundësitë e shkëmbimit ndërkombëtar të studentëve si Erasmus+, si dhe ka pjesëmarrje aktive në Panairin Work & Study çdo vit akademik. <i>Evidenca Nr. 94.- Pjesëmarrja në Panairret e Punës, Evidenca Nr. 90.- Pranimi i studentëve të rinj, aktivitetet, Evidenca Nr. 95.- Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.</i>

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstaton se, për studentët me aftësi të veçanta, nga pakicat apo shtresat në nevojë, të interesuar për të ndjekur programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet", Kolegji Universitar "LOGOS", ndjek një politikë gjithëpërfshirëse dhe mirëpritëse. Në bashkëpunim me Fondacionin LOGOS, institucioni angazhohet për të mbështetur këto kategori duke publikuar në mënyrë transparente oraret e pritjes për aplikantët, si dhe duke plotësuar dosjet për vlerësimin e kërkesave të tyre. Ky informacion është i disponueshëm në faqet zyrtare të institucionit dhe në mjediset e tij të brendshme. <i>Evidenca Nr. 87.- Leksione të Hapura KU Logos, Evidenca Nr.88.- Mjetet e komunikimit me studentët, Evidenca Nr. 89.- Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU "LOGOS" në shqip, Evidenca Nr. 90.- Pranimi i studentëve të rinj- aktivitetet, Evidenca Nr. 92.- Open Days, Evidenca Nr. 94.- Pjesëmarrja në Panairret e Punës.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstaton në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, se: -Kriteret e pranimi dhe kuotat për secilin program studimi janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe për çdo vit parashikohet edhe pranimi i studentëve të huaj/troje nga shtete të tjera. -Kolegji Universitar "LOGOS" informon dhe orienton në mënyrë transparente studentët e huaj/troje që dëshirojnë të ndjekin programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet", duke ofruar udhëzime të qarta mbi procesin, duke filluar nga njohja e diplomave nga MAS deri tek aplikimi përfundimtar. -Departamenti Financë Kontabilitet ngre një komision ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve, duke siguruar që të respektohen rigorozisht kriteret e transparencës, barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë. <i>Evidenca nr.70: Vendim për kriteret e pranimi ne programet e studimit qe ofron KU Logos, Evidenca Nr. 86.- Vendim Rektorati për organizimin e fushatës së Informimit 2020-2023; Evidenca Nr. 71.- Renditja e aplikanteve fitues ne programin e studimit Bachelor Financë Kontabilitet.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për	Bazuar në dokumentacion përkatës dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se:



shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	-Kolegji Universitar "LOGOS" ndjek një politikë të ndihmës/bursave të plota për disa kategori studentësh, duke ofruar bursat sociale për shtresat në nevojë, bursat mbështetëse për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi, bursat nga partnerët, si dhe bursa merite për studentët me rezultate të larta që dëshirojnë të ndjekin programin e studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet". -Informacioni për bursa publikohet në mënyrë transparente, duke përfshirë oraret e pritjes për kandidatët në këto kategori, të cilat janë të disponueshme në faqen zyrtare të institucionit dhe në mjediset brenda tij në tabelat e buletinit. <i>Evidenca Nr. 87.- Leksione të Hapura KU Logos 2019-2022, Evidenca Nr.88.- Mjetet e komunikimit me studentët, Evidenca Nr. 89.-Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU "LOGOS" në shqip, Evidenca Nr. 90.- Pranimi i studentëve të rinj- aktivitetet, Evidenca Nr. 92.- Open Days, Evidenca Nr. 94.- Pjesëmarrja në Panairët e Punës, Evidenca nr.106.- Bursat e akorduara në programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet per vitet 2020-2023.</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: -KU "Logos" përdor mjete informimi për publikun për të komunikuar kriteret, procedurat e pranimi dhe të transferimit, duke siguruar transparencë dhe qasje të lehtë për informacionin. -Në programin e studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" të KU "Logos", pranimi i studentëve çdo vit akademik bëhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. Të gjithë aplikantëve për studentë u ofrohen shanse të barabarta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të	GVJ konstaton se: -Në Rregulloren e Departamentit Financë Kontabilitet dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Financë


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Kontabilitet”, janë përmendur të gjitha kriteret për progresin e studentëve për të përmbyllur vitin akademik. Këto kritere janë të aksesueshme në web dhe gjithashtu përcillen në mënyrë verbale nga sekretaria mësimore dhe personeli akademik në auditor. -Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës organizon aktivitetin “Njihu me Kolegjin Universitar “LOGOS”, në fillimin e çdo viti akademik për studentët e regjistruar rishtaz, të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. -Kolegji Universitar “LOGOS” angazhon personelin akademik dhe administrativ për informimin dhe këshillimin e studentëve nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me studentët. -Fakulteti Ekonomik organizon takime informuese për studentët që janë duke përfunduar nivelin Bachelor për t’i orientuar ata për mundësitë e studimeve pasuniversitare në nivelin Master Profesional dhe Shkencor në Financë Kontabilitet. -Studentët informohen vazhdimisht për mundësitë e studimeve të ardhshme dhe për informacione të tjera përmes kanaleve të ndryshme si e-mail, rrjetet sociale Facebook dhe Instagram, si dhe platformat Microsoft Teams dhe Edupage. <i>Evidenca Nr. 4.- Rregullore e Departamentit Finance Kontabilitet, Neni 34 Evidenca Nr.9.- Rregullore e sekretarisë mësimore, Evidenca Nr. 91.- Orientimi dhe Këshillimi i studentëve tanë për kalimin në Ciklin e Dytë të studimeve, Evidenca nr.11 - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se: -Fakulteti Ekonomik i Kolegjit Universitar LOGOS zbaton Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe kriteret e sistemit të Bolonjës për ofrimin e mundësive për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion ose institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. -Departamenti Financë-Kontabilitet, ngre komisione ad-hoc, të cilat quhen Komisionet për Transferim dhe Program të Dytë Studimesh. Këto komisione krijohen me vendim të Dekanit dhe miratohen nga Rektori i Kolegjit Universitar “LOGOS”. <i>Evidenca nr. 1: Statuti i KU “LOGOS”, Evidenca nr. 4 : Rregullorja e Departamentit Finance Kontabilitet, neni 19). (Evidenca nr. 77. Udhezim (Rregullore) e Transferimeve; Evidenca nr. 76: Vendimet e Dekanatit FE për ngritjen e</i>



	<i>Komisionit për transferimet, Evidenca nr. 78. Template me të dhënat e aplikantëve për transferim studimesh, Evidenca nr.5: Rregullore Programit të studimit Bachelor Finance Kontabilitet</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" ka në fokus mbarëvajtjen e mësimnxënies dhe informimin e vazhdueshëm të studentëve. -Vlerësimi i dijeve bëhet përmes testeve të programuara në syllabus, si testi i ndërmjetëm, testi përfundimtar dhe detyrave të kursit, duke aplikuar vlerësimin e vazhdueshëm. -Përveç komunikimit verbal, informimi bëhet edhe përmes platformave online që KU LOGOS vë në përdorim. -Në fillim të çdo semestri, lektori i lëndës informon studentët e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve për çdo lëndë dhe depoziton Syllabusin përkatës në platformën Microsoft Teams dhe Edupage. -Për të ndihmuar në informimin e studentëve, institucioni ka vendosur struktura të tjera mbështetëse, si koordinatore, pedagogë për udhëheqjen e punimeve të diplomës, dhe pedagogë udhëheqës për ndjekjen e praktikave profesionale. <i>Evidenca nr 24.- Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet"; Evidenca nr. 26.- Syllabuset e programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet", Evidenca nr 44. -Vendime te Dekanit të Fakultetit Ekonomik për caktimin e Koordinatorëve sipas programit të studimit, Evidenca nr.3- Rregullore e Fakultetit Ekonomik të KU LOGOS, Evidenca nr. 14. Udhëzim për Përgatitjen dhe Mbrojtjen e Temës së Diplomës; Evidenca nr 74.- Dokumentat për praktikën profesionale për studentët e programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet".</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstaton se: -Departamenti Financë Kontabilitet organizon takime informuese me studentët e programit të studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet", për kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe provimit të formimit. -Studentët kanë akses të plotë në këto kriteret dhe procedura, si dhe në template-n e punimit të diplomës, përmes klasave virtuale në platformën Microsoft Teams. -Rregullorja e Departamentit Financë Kontabilitet përmban të gjithë informacionin në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës, provimit të formimit dhe diplomimit në programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet".




	-Studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës apo provimin e formimit pa përmbushur të gjitha detyrimet akademike dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planin mësimor të programit përkatës të studimit. <i>(Evidenca nr.4 : Rregullorja e Departamentit Financë Kontabilitet, Neni 44,45, 46, 47, 48, 49, 50, 51; Evidenca nr. 14. Udhëzim për Përgatitjen dhe Mbrojtjen e Temës së Diplomës), Evidenca nr.5:Rregullore Programit te studimit Bachelor Finance Kontabilitet.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" organizon fushata të gjera informimi, rreth 6 muaj përpara fillimit të çdo viti akademik, për të njohur kandidatët për studentë me ofertën akademike, institucionin, procesin mësimor dhe formues, praktikat profesionale dhe mundësitë për shkëmbime ndërkombëtare ERASMUS+. - Siç rezulton nga Evidenca nr. 86: Vendim Rektorati për organizimin e fushatës së Informimit 2020-2023, për organizimin e fushatës së informimit, në funksion të këshillimit të karrierës dhe rekrutimit të kandidatëve për studentë, ngrihet një grup pune. -Kolegji përdor një larmë mjetesh informimi, përfshirë: <i>Faqen zyrtare të institucionit</i> <i>Fletëpalosje dhe broshura informative</i> <i>Ditë informimi dhe këshillimi karriere</i> <i>Ditë të hapura</i> -Kolegji Universitar "LOGOS" fton vazhdimisht studentët potencialë në ambientet e amfiteatrit të tij, për të ndjekur aktivitetet që organizon, si leksionet e hapura etj <i>Evidenca nr 87. Leksione të Hapura KU "Logos", Evidenca nr.89-Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU "LOGOS" në shqip, Evidenca nr.95: Aktivitete KU Logos FE për vitet akademike 2020-2021,2021-2022, 2022-2023;. Evidenca nr.92-Open days, Evidenca nr.94-Pjesëmarrja në Panaiet e Punës.</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ofron informacion të vazhdueshëm për studentët lidhur me: <i>Procesin e transferimeve të studimeve</i> <i>Vlerësimin e dijeve</i> <i>Mbrojtjen e provimit final dhe punimin e temës së diplomës, në bashkëpunim me njësitë kryesore të institucionit.</i> - Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës është e funksion të informimit dhe këshillimit të studentëve




	<i>-KU "Logos" angazhon personelin akademik dhe administrativ për informimin e studentëve nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se: -Cdo fillim viti akademik, KU "Logos" informon studentët në mënyrë të hollësishme në lidhje me programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" përmes organizimit të aktivitetit "Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS". -Senatori i programit të studimit dhe koordinatori i programit, si pjesë e "Këshillit Studentor", shërbejnë për informimin e studentëve dhe për adresimin e problematikave të tyre në organet përkatëse. -Mjetet e tjera të informimit përfshijnë: <i>Faqja zyrtare e Kolegjit Universitar "LOGOS"</i> <i>Platforma EDUPAGE dhe Microsoft TEAMS</i> <i>Rrjetet sociale</i> <i>Komunikimi nëpërmjet adresave elektronike të pedagogëve dhe studentëve, për informacione mbi:</i> -Orarin mësimor -Aktivitetet, workshope-t dhe konferencat -Leksione të hapura -Oraret e konsultimeve nga pedagogët -Informacione mbi syllabuset -Institucioni përdor mjete të komunikimit të brendshëm si: <i>Postera të afishuara brenda institucionit</i> <i>Komunikimi verbal në auditor.</i> <i>Evidenca nr. 98: Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS, Evidenca nr.99: Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor; Evidenca nr.101: Financimi i veprimtarive të propozuara nga Këshilli Studentor; Evidenca nr.1: Statuti i KU "LOGOS" (Neni 40, neni 121). (Evidenca nr.88: Mjetet e komunikimit me studentët, Evidenca nr. 95. Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë qim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton se, në përputhje me procedurat e informimit dhe mbështetjes për studentët, Kolegji Universitar “LOGOS” ka implementuar praktika të qarta për informimin e tyre: -Studentët pajisen me dosjen e plotë të studentit, çdo fillim viti akademik, e cila përmban: -Kartën e studentit -Informacion mbi syllabuset, modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Gjatë periudhës së pandemisë, dosja e studentit iu është dërguar në mënyrë elektronike studentëve, për të siguruar percjelljen e informacionit. -Për çdo lëndë janë krijuar klasa virtuale dhe syllabuset e lëndëve, kurrikula e programit të studimit, si dhe materialet e leksioneve dhe seminareve janë publikuar në platformat e miratuara nga institucioni, si: EduPage Microsoft Teams. Kjo praktikë informimi vazhdon të zbatohet edhe pse tashmë mësimdhënie realizohet me prani fizike, duke përdorur të njëjtat platforma të përdorura gjatë periudhës së mësimdhënies online. <i>Evidenca nr.73 : Udhëzim 12 për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik në kushtet e pandemisë ; Evidenca nr. 98 : Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS; Evidenca nr.95- : Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU “Logos” për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstaton se, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen dhe integrimin e studentëve në tregun e punës. Rrjeti Logos-Alumni është një tjetër element kyç në lidhjen e studentëve me mundësitë e punësimit. Ky rrjet përfshin studentët e diplomuar në ciklin e parë Bachelor dhe në ciklin e dytë Master dhe ata mbledhin fonde për projekte dhe janë ideatorë të programeve të reja, krijojnë mundësi punësimi për studentët e rinj dhe promovojnë vazhdimisht KU LOGOS. <i>Evidenca nr.37: Marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset; Evidenca nr. 88: Mjetet e komunikimit me studentët, Evidenca nr.74.- Dokumentat për praktikën profesionale për studentët e programit të studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet”, Evidenca nr.102:- Të dhëna mbi ALUMNI në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Statistika punësimi analizë; Evidenca nr 95.- Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU “Logos” për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.</i>



Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar "LOGOS" ka një sistem të strukturuar dhe të vazhdueshëm informimi për studentët në lidhje me proceset mësimore dhe organizative. -Komunikimi realizohet përmes platformave të mësimi online si Microsoft TEAMS dhe Edupage, ku: Lektori krijon klasa virtuale sipas lëndëve për të ndarë informacionin mbi detyrat, detyrat e kursit, syllabusin, temat për studim, literaturën, materialet shtesë dhe metodat e vlerësimit. Informacioni në kohë reale për çdo ndryshim që ndikon në procesin mësimor, siç janë ndryshimet në orarin e mësimi, orarin e provimeve, sallat, dhe konsultimet, bëhet i disponueshëm përmes adresave të e-mail-it dhe faqes zyrtare të web. GVJ konstaton se, ky sistem i informimit dhe mbështetjes për studentët, ndihmon në krijimin e një ambienti të qartë dhe të koordinuar për të përmbushur kërkesat akademike dhe organizative të programit të studimit. <i>Evidenca nr.73: Udhëzim 12 për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik në kushtet e pandemisë; Evidenca nr.65: Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies. Evidenca nr.66: Manual i mesimdhënies Online Platforma Edupage dhe Microsoft Teams.</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstaton, bazuar dhe në takimin me studentët, se Kolegji Universitar "LOGOS", siguron një sistem të integruar për informimin dhe menaxhimin e aktiviteteve akademike për studentët. Çdo student pajiset me kredencialet për të aksesuar platformën virtuale Microsoft TEAMS dhe EduPage, ku: -Informacioni mbi programin e studimit është i disponueshëm dhe i përditësuar vazhdimisht. -Të dhënat dhe materialet akademike, duke përfshirë regjistrimin e studentëve dhe informacionet e tjera të rëndësishme deri në diplomim, përpunohen dhe transmetohen në këto platforma. -Ky sistem ofron një mundësi të vazhdueshme për studentët për të qenë të informuar dhe të përditësuar për zhvillimet akademike dhe administrative gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të tyre. <i>Evidenca nr.72.- Udhëzim nr.12 Për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik akademik në kushtet e pandemisë, Evidenca nr.65: Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies.</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se:

	- Mjetet kryesore të informimit për studentët janë: -Faqja zyrtare e Kolegjit Universitar "LOGOS" -Platformat EDUPAGE dhe Microsoft TEAMS -Rrjetet sociale -Adresat e e-mail-it Këto kanale përdoren për komunikimin e informacionit të rëndësishëm dhe për të siguruar që studentët të jenë të informuar në kohë reale për të gjitha zhvillimet dhe aktivitetet që lidhen me studimet e tyre. -Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës organizon në mënyrë të vazhdueshme aktivitete informuese për studentët, përmes një kalendari aktiviteteesh të miratuar çdo fillim viti akademik. Ky kalendar përfshin leksione të hapura, workshop-e, dhe seminare informuese që ndihmojnë në orientimin dhe zhvillimin e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstaton në bazë të vizitës në sekretarinë mësimore, se Kolegji Universitar "LOGOS": -Disponon të dhëna statistikore vjetore për programin mësimor Bachelor në Financë Kontabilitet, të cilat përpilohen në fillim dhe në fund të çdo viti akademik. Këto të dhëna përfshijnë informacion mbi: -Numrin e studentëve që kanë aplikuar -Numrin e studentëve që janë regjistruar -Numrin e studentëve të diplomuar Të dhënat ruhen në mënyrë elektronike dhe gjithashtu në hard copy në zyrën e sekretarisë mësimore dhe përcillen çdo vit në MAS. <i>Evidenca nr.9 : Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidenca nr.12: Rregullore Arkiv – Protokolli, Evidenca nr. 85: Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2020-2023.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të	Kolegji Universitar "LOGOS", ka një proces të strukturuar për menaxhimin e të dhënave të studentëve në programin Bachelor në "Financë Kontabilitet", bazuar kjo në Evidencat nr. 2, nr. 9,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 272-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	nr. 76 dhe nr. 77, dhe vizitës në sekretari, sipas të cilave, Sekretaria mësimore përgatit listat e studentëve çdo vit akademik për: -Studentët e regjistruar për herë të parë -Studentët që transferojnë studimet -Tërheqjet nga programi -Largimet para përfundimit të vitit akademik ose mos përfundimit me sukses Të dhënat e regjistrimit për studentët ruhen si në format elektronik ashtu edhe në format të shkruar me dorë dhe pasqyrojnë: -Regjistrimet -Largimet/çregjistrimet përpara përfundimit të studimeve Këto të dhëna mund të komunikohen me përgjegjësin e departamentit për përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit të brendshëm, pas kërkesës drejtuar Kryesekretarit. Në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar rishtazi (pa përfshirë transferimet) për programin Bachelor në Financë Kontabilitet, për tre vitet e fundit, ofrohet ky informacion: 2021-2022 11 studentë 2022-2023 9 studentë 2023-2024 7 studentë <i>(Evidenca nr. 2 : Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Neni 51, pika a, Evidenca nr.9 - Rregullore e Sekretarisë Mësimore Evidenca, Evidenca nr.76-Vendimet e Dekanatit për ngritjen e komisionit për transferimet FE, Evidenca nr.77-Udhezim (Rregullore) e Transferimeve, Evidenca nr.84: Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2020-2023.</i> <i>Vizita ne sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Bazuar në vizitën në sekretarinë mësimore gjatë të cilës u kontrolluan regjistri i regjistrimeve të studentëve, dokumentacioni i vlerësimit të tyre dhe databasa e informatizuar, GVJ konstaton se, Sekretaria mësimore e Fakultetit Ekonomik të KU "LOGOS" ka një sistem të mirëorganizuar për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave të studentëve. Ajo disponon statistika vjetore që përfshijnë: -Numrin e regjistrimeve për secilin vit akademik, sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. -Të dhëna të detajuara për: Numrin e studentëve për secilin vit akademik Transferimet dhe çregjistrimet Ecurinë akademike të studentëve Numrin e ECTS të grumbulluara për çdo vit akademik

	Studentët që diplomohen, përfshirë edhe temën e diplomimit. -Këto të dhëna mbahen si në formë elektronike ashtu edhe në format të shkruar me dorë dhe mund të përdoren për raportimin dhe monitorimin e ecurisë akademike të studentëve, si dhe për përgatitjen e raporteve të nevojshme për vetëvlerësimin e institucionit. Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm në versionin fizik, për çdo student të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, njëkohësisht dhe elektronikisht në sistemin e brendshëm të informacionit të KU "LOGOS". <i>Evidenca Nr. 85. Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2020-2023),</i> <i>Evidenca nr.9: Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar "LOGOS" përdor raporte vjetore për të vlerësuar gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhen me veprimtarinë e studentëve dhe menaxhimin e tyre. Sekretaria mësimore e Fakultetit Ekonomik mban statistika të detajuara për: -Numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik -Tërheqjet nga programi mësimor në Bachelor në Financë Kontabilitet -Largimet para përfundimit të programit -Notën mesatare hyrëse dhe dalëse për studentët. Ky proces i vlerësimit është i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e menaxhimit të informacionit të studentëve, duke siguruar që të dhënat dhe dokumentet të jenë të sakta dhe të përditësuara. <i>Evidenca nr.9 - Rregullore e Sekretarisë Mësimore,</i> <i>Evidenca nr.12- Rregullore Arkiv – Protokolli.</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në dokumentacionin dhe Analizën Vjetore të Kolegjit Universitar "LOGOS", GVJ konsaton se, ky i fundit, çdo vit akademik paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer nga njësitë bazë dhe kryesore pranë MAS-së. Ky raport përfshin, ndër të tjera: -Statistikat e cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve, -Shkallën e punësimit të studentëve pas përfundimit të programit të studimit në Bachelor në Financë Kontabilitet dhe programet e tjera të ofruara nga institucioni. -Marrëveshjet e bashkëpunimit, të lidhura nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, në bashkëpunim me Zyrën e Çështjeve Studentore, me institucione shtetërore dhe shoqëri




	private, në funksion të praktikave profesionale dhe integritit të studentëve në tregun e punës. Ky proces i raportimit dhe analizimit është një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe profesionalizmit të studentëve, duke ofruar mundësi për rritjen e bashkëpunimit me sektorin privat dhe shtetëror. <i>Evidenca nr 23. Raporti Vjetor i Departamentit Financë-Kontabilitet për vitet akademike: 2020-2021; 2021-2022, 2022-2023). (Evidenca nr. 32: Studim i Tregut të Punës Bachelor Financë Kontabilitet.</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" mban statistika të rregullta vjetore që përfshijnë: -Numrin e studentëve të regjistruar, -Numrin e studentëve të diplomuar, -Të dhëna rreth cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve. -Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës realizon analiza periodike të punësimit të studentëve pas diplomimit. Kjo analizë vendoset në dispozicion të Departamentit Financë Kontabilitet, i cili e përdor për hartimin e raporteve periodike mbi punësimin dhe suksesin profesional të studentëve pas diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe takimin me studentët, GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" garanton përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse, të tilla si këshillimi dhe vlerësimi i procesit akademik, përmes organesh kolegjiiale. Kjo përfshirje është e bazuar në Rregulloren e përgjithshme dhe Statutin e Kolegjit Universitar "LOGOS". -Studentët kanë të drejtën të kenë përfaqësues në organet kryesore të Kolegjit Universitar, përfshirë: <i>Senatin Akademik</i>, me një përfaqësues student nga programet e studimit, në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	përputhje me kuotat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (bazuar në Rregulloren e Kolegjit Universitar "LOGOS", nenet 25 dhe 26). -Studentët përfaqësohen në grupet e ndryshme të vlerësimit dhe akreditimit të programeve, përfshirë: <i>Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC), Komisionin e Përhershëm të Marrëdhënieve me Studentët, Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë (KPGSC), Këshillin Studentor dhe Këshillin e Etikës.</i> Kjo strukturë përfshirëse, siguron që studentët të kenë mundësi aktive në zhvillimin dhe përmirësimin e proceseve akademike dhe administrative, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe transparencës në institucion. <i>Evidenca nr 17. Përbërja e Senatit Akademik, Evidenca nr.100: Statuti i Këshillit Studentor; Evidenca nr.10:- Rregullore e Këshillit Studentor; Evidenca nr 99: Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor, Evidenca nr. 80.- Përbërja e Këshillit të Etikës, Evidenca nr. 109. Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Evidenca nr 110. Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe bazuar në Statutin e KU "LOGOS" dhe Rregulloren e Këshillit Studentor, GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" mbështet dhe nxit krijimin e organizmave studentorë, të cilat zgjidhen nga vetë studentët. Këto organizata monitorohen dhe mbështeten nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, duke siguruar një bashkëpunim të ngushtë me administratën. -Kolegji Universitar "LOGOS" trajton me prioritet kërkesat e studentëve për realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare dhe kërkesat për përmirësimin e shërbimeve. Aktivitetet që studentët kërkojnë dhe realizojnë janë të mbështetura dhe të inkurajuara nga institucioni, përfshirë organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve jashtëshkollore. Kjo praktikë tregon se Kolegji Universitar "LOGOS" është i angazhuar të krijojë mundësi të shumta për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve, duke siguruar një mjedis aktiv dhe mbështetës për të gjitha iniciativat e tyre. <i>Evidenca nr. 99. Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor, Evidenca nr 101. Fincimi i veprimtarive të propozuara nga Këshilli Studentor.</i>

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar LOGOS dhe Departamenti Financë Kontabilitet angazhohen në përfshirjen e studentëve, në vlerësimin e procesit akademik dhe përmirësimin e programeve të studimit përmes disa mekanizmave matës. Kjo përfshirje realizohet nëpërmjet: -Pyetësorëve të vlerësimit: Çdo student plotëson pyetësorë për të dhënë vlerësime dhe sugjerime në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky informacion është një mjet i rëndësishëm për grumbullimin e mendimeve të studentëve dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësim. -Përmirësimi i programeve të studimit: Sugjerimet dhe vlerësimet që mbledhen nga studentët përdoren për të përmirësuar programet e studimit dhe për t'i bërë ato më koherente me nevojat e tregut të punës. Ky proces është i lidhur ngushtë me hartimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të kurrikulave, për të siguruar që ato të jenë në përputhje me kërkesat dhe zhvillimet e industrisë. -Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje: Studentët janë të përfshirë në vendimmarrjen dhe proceset e ndryshme të Kolegjit Universitar LOGOS, duke dëshmuar mbështetje dhe vëmendje nga ana e institucionit për përfshirjen e tyre në këshillim dhe në organizimin e aktiviteteve akademike dhe administrative. Këto praktika dëshmojnë angazhimin e Kolegjit Universitar LOGOS për të përfshirë studentët në proceset e rëndësishme të vlerësimit dhe përmirësimit të kurrikulës, duke i dhënë atyre mundësinë të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të programeve mësimore. <i>Evidenca nr 111. Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022, 2022-2023, Evidenca nr 17. Përbërja e Senatit Akademik, Evidenca nr 80.- Përbërja e Këshillit të Etikës; Evidenca nr 99. Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor, Evidenca nr. 110. Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë. Evidenca nr.115-Pyetesor per vlerësimin e cilësisë se mësimdhënies nga studenti, Evidenca nr.116-Pyetësori i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë	GVJ konstaton, bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, se Departamenti Financë-Kontabilitet ka procedura të qarta dhe të strukturuar në lidhje me vlerësimin, ankimimin dhe rishqyrtimin e vlerësimit të studentëve. Këto procedura përfshijnë: -Të drejtën e studentit për ankimim: Studentët kanë të drejtë të ankohen për rezultatin përfundimtar të provimit, në përputhje




mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	me Nenit 40 të Rregullores së Departamentit të Financë-Kontabilitet. -Komisionin ad-hoc për ankimime: Kur një student paraqet ankesë, Departamenti Financë-Kontabilitet ngrë një komision ad-hoc, i cili përbëhet nga: <i>Përgjegjësi i Departamentit,</i> <i>Një anëtar pedagogu nga disiplinat përkatëse,</i> <i>Pedagogu i lëndës përkatëse.</i> -Rivlerësimi i provimit: Ky komision shqyrton pretendimet e studentit dhe rivlerëson tezën e provimit në përputhje me procedurat e përcaktuara. Vendimi i komisionit është përfundimtar dhe është i detyrueshëm për të gjitha palët. Kjo procedurë është një masë për të siguruar transparencën dhe drejtësinë në procesin e vlerësimit të studentëve dhe për të mundësuar një mundësi për rishqyrtim të rezultateve në rast se ka pretendime nga ana e studentëve..			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>-Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale brenda institucionit, siç janë:</i> <i>-Senati Akademik,</i> <i>-Këshilli i Përhershëm i Garantimit dhe Sigurimit të Cilësisë (KPGSC),</i> <i>-Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC),</i> <i>-Komisioni i përhershëm i marrëdhënieve me studentët,</i> <i>-Këshilli i Etikës, etj.</i> <i>Kjo përfshirje garanton pjesëmarrjen aktive të studentëve në vendimmarrje, këshillim, dhe vlerësimin e proceseve akademike, duke siguruar një lidhje të ngushtë mes studentëve dhe strukturave kolegjiale që menaxhojnë aspektet e ndryshme të jetës akademike dhe të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të	GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar Logos, përmes zyrave përkatëse, si Sekretaria Mësimore, Departamenti Financë Kontabilitet dhe Koordinatori për marrëdhëniet me studentët të programit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	mësimor, ka vendosur procedura të qarta për informimin e studentëve. -Këto procedura realizohen përmes njoftimeve të vazhdueshme në rrjetet sociale, web të institucionit, platformat online, dhe adresat e-mail të studentëve. -Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, si dhe koordinatorët akademikë në çdo departament, angazhohen në orientimin dhe këshillimin e karrierës për studentët, duke siguruar informacion të vazhdueshëm dhe mbështetje për përgatitjen e tyre për tregun e punës. -Kjo strukturë e informimit kontribuon në përmirësimin e komunikimit dhe orientimin e studentëve në çdo hap të jetës akademike dhe profesionale. <i>Evidenca nr. 11: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës; Evidenca nr.2: Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Neni 53; Evidenca nr. 44.-Vendime të Dekanit FE për caktimin e Koordinatorëve sipas programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstaton se: -Në faqen zyrtare të internetit të Kolegjit Universitar "Logos", studentët mund të gjejnë informacion të detajuar mbi mënyrën e regjistrimit, orarin mësimor, orarin e provimeve, aktivitetet për studentët, etj. -Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës organizon leksione të hapura, workshope dhe seminare informuese çdo vit akademik, të cilat synojnë orientimin e studentëve mbi aspekte të rëndësishme të edukatës financiare dhe përgatitjen për tregun e punës. Aktivitetet përfshijnë aplikimet për punë, hartimin e një letre motivimi dhe CV-je, si dhe përgatitjen për intervista pune. -Koordinatori akademik përgatit një plan për të ardhmen akademike të studentëve, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm të progresit akademik të tyre dhe duke ofruar udhëzime për zhvillimin e karrierës pas diplomimit. Kjo qasje siguron mbështetje dhe orientim të vazhdueshëm për studentët, duke i ndihmuar ata të bëjnë kalimin e suksesshëm nga jeta akademike në atë profesionale. <i>Evidenca nr 95. Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të	GVJ konstaton se: -Kolegji Universitar LOGOS ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani, të cilat ofrojnë




karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	mundësi për studentët e programit të studimit Bachelor në “Financë-Kontabilitet” për të kryer praktikat profesionale. Në disa raste, pas përfundimit të praktikave, studentët mund të punësohen. -Zyra e Karrierës dhe e Çështjeve Studentore, ka si mision përmirësimin e lidhjes së studentëve me tregun e punës, duke i mbështetur dhe inkurajuar ata në zhvillimin e plotë të potencialit të tyre, për të arritur një performancë më të mirë dhe një integrim më të shpejtë në treg. -Kolegji Universitar LOGOS organizon takime informuese me studentët që përfundojnë nivelin Bachelor, ku përfshihen Dekanët, Përgjegjësit e Departamenteve, staf i akademik dhe administrativ, si dhe përfaqësuesi i Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Gjatë këtyre takimeve, studentëve u ofrohen orientime për mundësitë e studimeve në ciklin e dytë Master, duke siguruar informacion dhe udhëzime për hapat e mëtejshëm të karrierës akademike. Ky sistem mbështetës i siguron studentëve mundësi të vazhdueshme zhvillimi dhe lidhje për mundësi punësimi dhe studimesh të mëtejshme. <i>Evidenca nr. 91: Orientimi dhe Këshillimi i studentëve tanë për kalimin në Ciklin e Dytë të studimeve, Evidenca nr 37. Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me bizneset.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstaton se: - Mbahet një komunikim i vazhdueshëm me kompanitë për të integruar studentët në tregun e punës, nga e Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik dhe Departamentin Financë-Kontabilitet. Ky proces fillon me realizimin e praktikave profesionale dhe vazhdon me mundësi punësimi të plotë ose të pjesshëm për studentët. -Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës disponon të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarve, duke ofruar informacion të detajuar për lidhjen mes diplomës dhe mundësive të punësimit. -Kolegji Universitar “LOGOS” ka organizuar Panairë të Punës në bashkëpunim me Fakultetet e tij, duke ftuar studentët që të marrin pjesë në to, ku ata mund të njihen me punëdhënës potencialë, të realizojnë intervista të drejtpërdrejta në stenda të punëdhënësve dhe të orientohen në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Ky përkushtim për të lidhur studentët me mundësi të drejtpërdrejta punësimi dhe për t’i përgatitur ata për të ardhmen është një element kyç i mbështetjes së tyre profesionale.



	Evidenca nr.104. Formular i Vlerësimit nga punëdhënësi për ish-studentin ALUMNI, Evidenca nr.105: Zyra Erasmus +; Evidenca nr 95. Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023; Evidenca nr 37. Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me bizneset, Evidenca nr 38. Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me institucione joarsimore, Evidenca nr.94: Pjesëmarrja në Panairët e Punës			
Konkluzione	GVJ konstatoi se: -Kolegji Universitar "LOGOS" ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme, të cilat ofrojnë mundësi për studentët e programit Bachelor në "Financë-Kontabilitet" për të realizuar praktikat profesionale, një mundësi kyçe për të fituar përvojë praktike dhe për të rritur mundësitë e punësimit pas diplomimit, -Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, së bashku me koordinatorin akademik, kryejnë aktivitete të qëndrueshme në funksion të informimit, orientimit dhe këshillimit të karrierës për studentët, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin e tyre profesional dhe akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	GVJ konstaton angazhimin e KU "Logos", për të integruar metoda të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Institucioni ka hartuar një sërë udhëzuesish, përfshirë: -Udhëzues për Mënyrën e Zhvillimit të Mësimin, Laboratorëve, Praktikave dhe Provimeve, -Udhëzues për Mësimin në Distançë për Studentët,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	-Manual për përdorimin e platformave si Microsoft Office 365 dhe Edupage. Të gjitha këto udhëzues janë të disponueshëm në gjuhën shqipe dhe angleze. Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se studentëve të këtij programi u ofrohen laboratorë me programe statistikore për përpunimin e të dhënave dhe laboratorë kompjuterikë të pajisur me software financiare dhe programe Office, që mbështesin zhvillimin e lëndëve që përfshijnë orë laboratorike. <i>Evidenca nr. 65: Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies; Evidenca nr. 66: Manuali i mësimdhënies online, Evidenca nr. 63: Manual i përdorimit të Platformës Edupage</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar “LOGOS”, monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike, aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe rishikimin e programeve të studimit, nëpërmjet Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe e zhvillon këtë aktivitet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të institucionit, si dhe me Politikën dhe Rregulloret për Sigurimin e Cilësisë. Bazuar në këto dokumente, janë hartuar udhëzues të posaçëm për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), konfirmoi se vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik kryhet dy herë në vit, në fund të çdo semestri, përpara fillimit të sezonit të provimeve. <i>Evidenca nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar “Logos”, Evidenca nr. 2: Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar “Logos”; Evidencat nr. 108- Politika për sigurimin e cilësisë, Evidenca nr. 6.-Rregullore për sigurimin e cilësisë, Evidenca nr.111- Raport vjetor i NJSBC për vitet akademike, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ-së iu komunikua se, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) siguron plotësimin e pyetësorëve online nga studentët, duke përdorur platformën Microsoft Teams, në fund të çdo semestri, përpara fillimit të sezonit të provimeve. Rezultatet e përfuara trajtohen nga anëtarët e NJSBC-së, firmosen dhe më pas raportohen Rektorit të KU “Logos”. Një element i rëndësishëm i këtij procesi është përfaqësimi i studentëve, të cilët kanë një përfaqësues në anëtarësinë e NJSBC-së dhe të Komisionit të Përgjithshëm të Sigurimit të Cilësisë (KPGSC).



	Gjithashtu, rezulton se, njësitë bazë kryejnë analiza të vazhdueshme për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, duke përdorur: -Pyetësorë të drejtuar studentëve në përfundim të një cikli studimesh, -Pyetësorë të drejtuar bashkëpunëtorëve në tregun e punës, për të marrë mendime mbi përshtatshmërinë e aftësive të studentëve, -Vlerësime të institucioneve ku studentët kryejnë praktikat profesionale, dhe -Mbledhje periodike, ku analizohen nevojat për përmirësime të identifikuar gjatë semestrit. Këto veprime kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe programeve mësimore. <i>Evidenca nr. 109: Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni; Evidenca nr. 110: Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Shtojcë nr. 116: Pyetësori i departamenti drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit, Evidenca nr.111- Raport vjetor i NJSBC për vitet akademike, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023)</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezulton se NJSBC, në rutinën e punës së saj, harton Raporte Semestrale dhe Raporte Vjetore. Këto raporte publikohen nga Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë (KPGSC), në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë. Rezulton se, gjithashtu, KPGSC harton raporte periodike që analizojnë gjetjet nga proceset e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Po kështu dhe Fakulteti Ekonomik përgatit raportin e tij vjetor, rezultatet e të cilit përfshihen në Raportin Institucional të KU "Logos". Ky raport kalon për miratim në strukturat drejtuese të institucionit, si: -Rektorati, -Senati Akademik, dhe -Bordi i Administrimit. Pas miratimit, Raporti Institucional dorëzohet pranë Ministrisë së Arsimit, duke përmbushur detyrimet ligjore të KU "Logos". <i>Evidenca nr. 21: Raporti Vjetor Institucional për vitet akademike: 2020-2021; 2021-2022, 2022-2023; Evidenca nr. 111: Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022, 2022-2023; Evidenca nr. 22: Raporti Vjetor i Fakultetit Ekonomik për vitet akademike: 2020-2021; 2021-2022;2022-2023;</i>

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga vizita në institucion, GVJ evidentoi se analiza e rezultateve të vlerësimeve, nga raportimet e kryera nga NJSBC dhe KPGSC, përcillet në Senatin Akademik, në bazë të së cilës, ky i fundit, merr në konsideratë kryerjen e propozimeve në formën e rekomandimeve drejtuar njësive kryesore. Këto, transformohen në masa konkrete operative për përmirësimin e programeve të studimit të ofruara. Në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të KU Logos dhe planin mësimor, janë diskutuar, zbatuar dhe bërë publike praktikatat më të mira në njësitë bazë dhe ato kryesore. Për realizimin e këtyre qëllimeve janë organizuar takime me studentët, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë rolin dhe vlerën e këtyre praktikave. Gjithashtu, nga analiza e raportimeve, janë propozuar tematika për mbështetje trajnuese të stafit akademik, mbi të cilat është hartuar plani i trajnimit për stafin. <i>Evidenca nr. 87: Leksione të Hapura KU “Logos” 2020-2023; Evidenca nr. 95: Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU “Logos” për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023), Evidenca nr.45: Trajnime nga institucioni për mësimdhënien,</i> <i>Evidenca nr.112:Trajnime të stafit akademik organizuar për sigurinë e cilësisë në mësimdhënie.</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Cilësisë në KU Logos:</i> <i>-përbushin detyrat e tyre në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi dhe rregulloret e brendshme të KU Logos,</i> <i>-sigurojnë përfshirjen aktive të studentëve në aktivitetet e tyre,</i> <i>-ndjekin me kujdes realizimin e rekomandimeve të dhëna prej tyre.</i> <i>-Kolegji Universitar Logos është i angazhuar në përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika,	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar "LOGOS" ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përkatësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al



struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni dhe Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Sigurimit të Cilësisë, veprimtaria e të cilave mbështetet në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë. Po ashtu, siç përcakton pika 5 e nenit 103 të Ligjit nr. 80/2015, institucioni ka hartuar politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë harton dokumentin e politikës për sigurimin e cilësisë, i cili miratohet nga Senati Akademik. <i>Evidenca nr. 109: Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni, Evidenca nr. 110: Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Shtojcë nr. 6: Rregullore për sigurimin e cilësisë, Shtojcë nr 108. Politika për sigurimin e cilësisë</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstaton se, në KU Logos funksionojnë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, për të garantuar plotësimin e standardeve shtetërore të cilësisë. Po kështu, institucioni bashkëpunon me një ekspert të jashtëm, i cili është anëtar i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sistemi i sigurimit të cilësisë monitoron, vlerëson dhe ndjek procesin e mësimdhënies. Studentët janë pjesë e anëtarësisë në të dyja strukturat dhe luan një rol aktiv në proceset e cilësisë. <i>Shtojcë nr . 15: Plan i strategjik i Kolegjit Universitar "Logos", 2018-2024, Evidenca nr. 109: Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni; Evidenca nr. 110: Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Tabela 24 – Përbërja e NJSBC-së & KPGSC</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e	GVJ-ja konstaton se, politika për sigurimin e cilësisë në Kolegjin Universitar "LOGOS", udhëheq procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit, garantimit dhe përmirësimit të cilësisë së Institucionit e programeve që ai ofron, duke u bazuar në kritere të brendshme e të jashtme. Rezulton se, në Kolegjin Universitar "LOGOS" sigurimi i cilësisë realizohet nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë dhe konsiston në: -vlerësimi i brendshëm në nivelin e institucionit, të njësive kryesore, të njësisë bazë; -vlerësimi i brendshëm për programet e studimit dhe mësimdhënien; -vlerësimin e veprimtarive kërkimore-shkencore; -vlerësimin e cilësisë së arritjeve të studentëve;




përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	-vlerësimin e ecurisë së punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga KU "Logos" në bashkëpunim gjithashtu me Zyrën e Koordinimit të Çështjeve Studentore. GVJ konstaton se, NJSBC kujdeset për vlerësimin e gjetjeve nga rezultatet e anketimeve, duke hartuar përmirësimet e nevojshme në planin mësimor dhe duke rishikuar syllabus-et, për të siguruar përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. <i>Evidenca nr. 108: Politika për sigurimin e cilësisë, Evidenca nr. 111: Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023; Evidenca nr. 21: Raporti Vjetor Institucional për vitet akademike: 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023; Evidenca nr. 22: Raporti Vjetor i Fakultetit Ekonomik për vitet akademike: 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023; Evidenca nr. 23: Raporti Vjetor i Departamentit Financë-Kontabilitet për vitet akademike: 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023; Evidenca nr. 27: Procesverbal për përditësimin e miratimit të syllabuseve, Evidenca nr. 113: Paketa e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë NJSBC.</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Rezulton se, Kolegji Universitar "LOGOS", me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, në përputhje me rregulloren për sigurimin e cilësisë, ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron. GVJ konstaton se, Kolegji Universitar "LOGOS" ka ndërtuar veprimtarinë e tij për sigurimin e cilësisë duke u mbështetur në dy qasje: a) Qasja "cilësia si përputhje me misionin dhe qëllimin", dhe b) Qasja e "bazuar në standarde". <i>Evidenca nr. 108: Politika për sigurimin e cilësisë, Shtojcë nr. 6: Rregullore për sigurimin e cilësisë,</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - KU "LOGOS" ka ngritur dhe ka vënë në funksionim Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, për të identifikuar përgjegjësitë funksionale të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet. -Kolegji Universitar "LOGOS" ka ngritur struktura dhe ndjek procedura të qarta për sigurimin e brendshëm të cilësisë. -Institucioni angazhohet për krijimin e një kulture cilësore në tërësinë e tij, duke e bërë sigurimin e cilësisë përgjegjësi të të gjithëve dhe duke e integruar vlerësimin si pjesë të pandashme të aktivitetit të tij.



	<i>-Studentët janë pjesë e anëtarësisë së Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucionit i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucionit i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ, bazuar në takimin me NJSBC-në, vlerëson se, NJSBC-ja mbikëqyr procesin e komunikimit dhe publikimit të vlerësimit. Për këtë proces, NJSBC-ja harton një raport, i cili i dërgohet Rektorit të Kolegjit Universitar "LOGOS", i cili raporton në Senat. Raporti më pas i dërgohet drejtuesve të njësive kryesore, të cilët e përcjellin tek drejtuesit e njësive bazë. GVJ konstaton se, Kolegji Universitar "LOGOS" siguron mekanizma dhe procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve, nëpërmjet planeve të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të standardeve shtetërore të cilësisë për Institucionin dhe programet që ai ofron. Vihet re se rezultatet e raportit të NJSBC-së i komunikohen personelit akademik të departamentit, ndërsa vlerësimet individuale për secilin prej tyre iu komunikohen nga Drejtuesit e njësive bazë. Në lidhje me gjetjet e NJSBC-së, Departamenti gjykon se çfarë duhet të konsiderohet dhe harton kalendarin dhe planin e përmirësimeve të synuara, si dhe cakton personat përgjegjës për realizimin e tyre. Ky plan dërgohet për miratim në Senat. Departamenti njofton Rektorin për ecurinë dhe realizimin e gjetjeve dhe e mban të informuar NJSBC-në mbi progresin e përmirësimeve të nevojshme. Nga shqyrtimi i Raporteve të NJSBC vërehet se nuk ka pasur problematika lidhur me vlerësimet e studentëve nëpërmjet pyetësorëve. Po ashtu, GVJ konstatoi se departamentet propozojnë ndryshime deri në masën 20% për përmirësimin e programit të studimit brenda periudhës kohore të akreditimit të radhës, sipas legjislacionit në fuqi, si pjesë e monitorimeve për matjen e cilësisë së programeve të studimit të ofruara. <i>Evidenca nr. 111: Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022, 2022-2023; Evidenca nr. 116: Pyetësori i departamentit</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimn. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit; Evidenca nr. 23: Raporti Vjetor i Departamentit Financë-Kontabilitet për vitet akademike: 2020-2021; 2021-2022, 2022-2023;</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Rezulton se, raportet e NJSBC-së: -evidentojnë krahasimet e rezultateve semestrale dhe vjetore për cilësinë e mësimdhënies, -pasqyrojnë sugjerimet objektive të studentëve, -adresojnë mangësitë e evidentuara, -sugjerojnë masat e nevojshme që duhet të merren për përmirësimin e cilësisë. GVJ vlerëson se KU "LOGOS" mbështet stafin në rritjen e formimit të tyre akademik dhe shkencor, duke ofruar trajnime për metodat e mësimdhënies nga ekspertë të huaj dhe profesorë të Universiteteve partnere. Gjithashtu, institucioni ka rritur numrin e mobiliteteve të stafit akademik me universitete partnere në kuadër të programit Erasmus+. Në dosjen e personelit akademik efektiv të shqyrtuar nga GVJ, u vërejt mbështetja financiare e institucionit për studimet e doktoratës dhe pjesëmarrjen e stafit në konferenca shkencore. <i>Evdienca nr.45-Trajnime nga institucioni për mësimdhënien, Evidenca nr. 112: Trajnime të stafit akademik organizuar për sigurinë e cilësisë në mësimdhënie; Evidenca nr. 85: Praktika te mbështetjes financiare te stafit nga Institucioni; Evidenca nr. 31: Mobilitete të stafit akademik në kuadër të Erasmus +, Evidenca nr. 111: Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022;2021-2022; Evidenca nr. 114: Procedura e administrimit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga NJSBC.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të	GVJ vlerëson se, Kolegji Universitar "LOGOS" përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit, duke përfshirë:-Plotësimin e formularëve të vlerësimit nga studentët në fund të çdo semestri para sezonit të provimeve, me qëllim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. -Vlerësimin e didaktikës dhe kurrikulës, nëpërmjet përditësimit të kurrikulave ekzistuese me qëllim zhvillimin e tyre bazuar në kompetenca dhe kërkime, duke e pasur në qendër studentin.-Përpjekjes për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut, etj. NJSBC, organizon e monitoron në fund të çdo semestri, para fillimit të sezonit të provimeve, procesin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët dhe në fund të vitit akademik vlerësimin e veprimtarisë së departamentit. Rezulton se, Kolegji Universitar "LOGOS", e ka parashtruar në strategjinë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	e tij të zhvillimit objektivin prioritar të hartimit të instrumenteve të vlerësimit të kurrikulës; sipas rastit nëse ka kontestime nga ana e studentëve, bëhen vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, megjithëse kriteret e vlerësimit janë transparente dhe të qarta; <i>Evidenca nr.113: Paketa e instrumenteve të NJSBC-së; Evidenca nr.115: Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët, Shtojcë nr. 15: Plani strategjik i zhvillimit të KU "Logos", 2018-2024, prioriteti strategjik 2, fq 17</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ konstaton se, për të vlerësuar realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit, KU "LOGOS", përdor disa instrumente të tërthorta, si: -Pyetësorë të studentëve në fund të një cikli studimi, të hartuar nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e kurrikulës së ofruar. -Pyetësorë të studentëve të diplomuar, anëtarë të LOGOS Alumni, aktivë në tregun e punës. -Raporte të vlerësimit të jashtëm të ekspertëve të fushës gjatë proceseve të akreditimeve të mëparshme të programit. -Pyetësorë për institucionet publike dhe private me të cilat institucioni bashkëpunon për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve. <i>Evidenca nr. 116: Pyetësori i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit, Evidenca nr. 103: Formular ALUMNI, Evidenca nr. 104: Formular i Vlerësimit nga punëdhënësi për ish-studentin ALUMNI</i>			
Konkluzione	GVJ evidenton se: -Kolegji Universitar "LOGOS" ka ngritur struktura dhe ndjek procedura të qarta për sigurimin cilësisë së mësimdhënies, -Këto struktura, realizojnë procesin e sigurimit të cilësisë në mënyrë periodike, -Këto struktura përdorin metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në këtë proces.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizita në institucion, GVJ vlerëson se, KU "LOGOS", përdor një sërë mekanizmesh për të siguruar dhe vlerësuar cilësinë e programeve të studimit, duke përfshirë: -Monitorimi i procesit mësimor nga autoritetet drejtuese. -Anëtarësimi i studentëve në organet drejtuese të Kolegjit Universitar "LOGOS", në analizat e punës dhe komisionet e ndryshme. -Marrja e mendimit të studentëve me qëllim përmirësimin e programeve të studimit. -Mbledhja e të dhënave në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar në programet e studimit që ofron institucioni. -Përdorimi i Standardeve Shtetërore të Cilësisë të përcaktuara në Kodin e Cilësisë, publikuar nga ASCAL, për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. -Anëtarësimi i një eksperti të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <i>Evidenca nr. 115: Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët, Evidenca nr. 109: Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni; Evidenca nr. 110: Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Evidenca nr. 116: Pyetësori i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit, Evidenca nr. 102: Të dhëna mbi ALUMNI në programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet, Statistika punësimi analizë</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ konstaton se, institucioni ka përcaktuar qartë në rregulloren për sigurimin e cilësisë, përgjegjësitë dhe detyrat për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Ky konstatim vjen pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues, bazohet në informacionin e paraqitur në Raportin e vetëvlerësimit, si dhe në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar "LOGOS". Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, në Komisionin e Garantimit të Standardeve të Cilësisë, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, çka garanton pjesëmarrjen e tyre aktive në çështjet që lidhen me cilësinë e arsimit dhe shërbimeve që ofron institucioni.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Evidenca nr.80-Perberja e Këshillit të Etikes, Evidenca nr.109-Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucioni, Evidenca nr.110-Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Evidenca nr.17-Perberja e senatit Akademik, Evidenca nr.6-Rregullore për sigurimin e cilësisë.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ konstaton se, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë të programeve të studimit që ato ofrojnë, në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë, përcaktohen në rregulloren për sigurimin e cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje, Drejtuesi i Njesisë Kryesore, është përgjegjës për garantimin e kushteve të duhura për realizimin e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit, në kuadër të sigurimit të cilësisë në njësinë kryesore dhe garanton se rezultatet e vlerësimeve kthehen në masa operative konkrete për përmirësimet e duhura. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm i Njesisë Bazë është një organ ad-hoc që formohet çdo herë që ndërmerren veprimtari vlerësimi. Ky grup ka detyrën e kryerjes së vlerësimeve të brendshme për njësinë bazë, duke ndjekur procedurat e parashikuara në Manualin e Cilësisë. Kjo strukturë ka një rol të rëndësishëm në sigurinë dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe aktiviteteve akademike që ofrohen nga njësiti bazë të institucionit. <i>Evidenca nr.6-Rregullore për sigurimin e cilësisë</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstaton se, studentët kanë iniciativë dhe përfshihen në proceset e vlerësimit. Rezulton se, KU "LOGOS", synon të përfshijë studentët e viteve të para të studimit për t'u angazhuar në grupet e vlerësimit të brendshëm, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e sigurimit të cilësisë dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë. Po kështu, GVJ konstaton se, KU "LOGOS" shmang çdo formë diskriminimi apo pabarazie ndaj personelit dhe studentëve, duke përfshirë të gjithë aktorët e brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, duke kontribuar në ruajtjen e integritetit akademik të institucionit. <i>Evidenca nr.109-Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucioni, Evidenca nr.110-Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Evidenca nr.17-Perberja e senatit Akademik.</i>




Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ vlerëson se, pedagogët e ftuar, me përvojë të gjatë në arsim me tituj akademikë e grada shkencore dhe specialistët në fusha përkatëse bashkëpunojnë me KU “LOGOS” dhe japin ekspertizë e mendime për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe përmirësimin e tyre. Pjesë e këtij procesi janë dhe bashkëpunëtorët e KU “LOGOS” në tregun e punës, specialistë nga institucionet ku studentët kryejnë praktikat profesionale, si dhe punëdhënësit e studentëve të diplomuar në KU “LOGOS”, me të cilët kolegji ruan marrëdhënie bashkëpunimi strategjike. <i>Evidenca nr. 11: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, Evidenca nr. 102: Të dhëna mbi ALUMNI në programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet, Statistika punësimi analizë</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se: -Kolegji Universitar “LOGOS” përfshin në mënyrë aktive dhe efikase njësitë mësimdhënëse, stafin, ekspertë të jashtëm dhe studentët në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. -Kjo përfshirje e gjerë siguron një proces të strukturuar dhe gjithëpërfshirës, ku të gjithë aktorët kanë mundësi të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë akademike dhe administrative të institucionit. -Procesi i përfshirjes është i hapur dhe transparent, duke ndihmuar në rritjen e përgjegjësisë dhe angazhimit të çdo anëtarit të komunitetit akademik për ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar “LOGOS”, në faqen e tij zyrtare ka të publikuar të plotë: -planin e tij strategjik të zhvillimit; http://www.kulogos.edu.al/al/strategicplan.html); -informacion mbi veprimtarinë e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, mbi veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html) dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	mbi veprimtarinë e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë; (http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance-committee.html); -Kodin e Cilësisë; (http://www.kulogos.edu.al/al/higher-education-quality-code.html); -Politikën e Cilësisë (http://www.kulogos.edu.al/al/quality-policy.html); -Manualin e Cilësisë (http://www.kulogos.edu.al/al/regulation-onquality-assurance.html). -vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit si vlerësim i jashtëm (http://www.kulogos.edu.al/al/external-evaluation.html)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar “LOGOS” siguron që të respektohen standardet e lirisë dhe etikës akademike, duke implementuar një rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Ky angazhim është pjesë e përpjekjeve të Kolegjit për të realizuar misionin, vizionin dhe vlerat e tij, duke garantuar një proces të besueshëm dhe të sigurt për menaxhimin e informacionit të studentëve dhe stafit. Rezulton se, Kolegji Universitar “LOGOS” dhe njësitë kryesore, komunikojnë dhe publikojnë rezultatet e monitorimit, vlerësimit dhe akreditimeve, të cilat publikohen dhe në faqen zyrtare. <i>Evidenca nr. 7: Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstaton se, për çdo fillim viti akademik, Departamenti Financë-Kontabilitet evidenton nevojat për përmirësime dhe përditësime të programeve të lëndëve, duke monitoruar kriteret e kurrikulave dhe duke ndërmarrë masat operative të nevojshme për përmirësimet e kërkuara. GVJ vlerëson se, Kolegji Universitar “LOGOS”, duke u mbështetur në monitorimin e vazhdueshëm të treguesve të cilësisë nga strukturat dhe autoritetet përgjegjëse përkatëse, siguron që rezultatet e vlerësimeve të merren seriozisht dhe se një plan masash i detajuar hartohet për të adresuar mangësitë dhe dobësitë e evidentuara, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve dhe aktivitetit mësimor. <i>Evidenca nr.27-Procesverbal për përditësimin e miratimin e syllabuseve, Evidenca nr.45-Trajnime nga institucioni për mësimdhënien, Evidenca nr.60-Kerkesa e Departamentit</i>




	<i>Finance-Kontabilitet drejtuar Bibliotekës për libra të rinj, Evidenca nr.108- Politika për sigurimin e cilësisë, Evidenca nr.112-Trajnime të stafit akademik organizuar për sigurinë e cilësisë në mësimdhënie, Evidenca nr.115-Pyetesor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studenti, Evidenca nr.116-Pyetëtori i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vlerëson disa rezultate pozitive të veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS”, ku mund të përmenden: -Përmirësimi i performancës së stafit akademik, i dukshëm në rritjen e numrit të stafit akademik që ka fituar grada shkencore ose që është në proces të tyre, si dhe në rritjen e numrit të mobiliteteve të stafit akademik. -Kurrikula e përmirësuar e zhvilluar me fokus studentin dhe bazuar në kompetenca, duke pasqyruar përpjekjet për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. -Zgjerimi i rrjetit të bashkëpunëtorëve me partnerë të jashtëm, përfshirë institucione akademike dhe përfaqësues të industrisë, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ofrimin e mundësive të reja për studentët. -Cilësia e studentëve të diplomuar, ardhur në përmirësim të vazhdueshëm, të cilët janë më të përgatitur për tregun e punës dhe për sfidat profesionale. -Investimi në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe kushteve infrastrukturore duke ofruar një ambient mësimor më të përshtatshëm dhe më cilësor. -Rritje e kohëzgjatjes së akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, gjë që pasqyron besueshmërinë dhe cilësinë e ofruar nga institucioni. Këto përmirësime dhe arritje janë dëshmi e angazhimit të Kolegjit Universitar “LOGOS” për të siguruar cilësi të lartë në proceset e mësimdhënies, kërkimit dhe shërbimeve për studentët. <i>Evidenca nr.22-Raport vjetor i Fakultetit Ekonomik, për vitet akademike 2020-2021,2021-2202,2022-2023,Evidenca nr.26-Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Finance Kontabilitet, Evidenca nr.29-CV-te e pedagogeve që japin mësim në programin BCH FK, Evidenca nr.31-Mobilitete të stafit akademik dhe studenteve në kuadër të Erasmus+, Evidenca nr.36-Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me IAL brenda dhe jashtë vendit, Evidenca nr.37-Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me bizneset.</i>




Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vlerëson se, Kolegji Universitar “LOGOS” angazhohet për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe programeve të studimit, duke zhvilluar aktivitete të ndryshme për informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit. Disa nga veprimtaritë kryesore përfshijnë: -Bashkëpunimi me ASCAL për trajnimin e stafit dhe studentëve, në lidhje me rëndësinë e zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve, si një nga mekanizmat kryesorë për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në vend. -Zhvillimin e seancave informuese për studentët nga NJSBC, mbi rëndësinë e zhvillimit të pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. -Angazhimin e stafit të ri akademik në proceset e vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit, me qëllim trajnimin dhe përfitimin e përvojës në këtë fushë, për të krijuar dhe forcuar një kulturë cilësie gjithëpërfshirëse në institucion. <i>Evidenca nr.113-Paketa e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë NJSBC.</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: -KU Logos ka ndërmarrë masa për të përmirësuar cilësinë si trajnime për stafin akademik dhe rritje të mundësive për mobilitete në kuadër të programit Erasmus+. -KU “LOGOS” ka përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat e njësive, individëve, studentëve dhe palëve të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, sipas rregullores për sigurimin e cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	-----------------------------------

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Kontabilitet" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar LOGOS"

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u realizua në kushtet e një bashkëpunimit plotë me strukturat e institucionit dhe bazuar në një informacion të plotë dhe transparent në përmbushje të objektivit sa më të plotë të vlerësimit të këtij programi.

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi ofrohet nga një staf akademik i kualifikuar dhe me përvojë të gjatë akademike shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe i profilizuar në lëndët karakteristike të programit.
2. KUL garanton qëndrueshmërinë financiare për mbështetjen financiare të nevojshme të procesit mësimor kërkimor jo vetëm nga tarifat e studentëve por kryesisht nga mbështetja financiare në formën e donacioneve nga Fondacioni LOGOS.
3. Vendndodhja e përshtatshme e godinës së KUL ku zhvillohet procesi mësimor i këtij programi ofron lehtësira transporti dhe komunikimi për studentët e tij.
4. Institucioni disponon infrastrukturën e përshtatshme për zhvillimin me efektivitet të programit të studimit nëpërmjet laboratorëve tashmë të rinovuar dhe bashkëkohor si dhe të një fondi fizik dhe elektronik të pasur me literaturën e fushës së financës dhe kontabilitetit.
5. KUL dhe FE janë aktive në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura me universitete homologe të huaja, kryesisht të Greqisë duke mundësuar numër të kënaqshëm mobilitetesh për stafin dhe studentët.

Pika të dobëta

1. Numri i ulët i studentëve të regjistruar në këtë program rrezikon vazhdueshmërinë e programit në një të ardhme afatmesme.
2. Konkurrencë e lartë nga programe të ngjashme bachelor, të cilat ofrohen nga universitete të tjera publike dhe private në vend.

Rekomandime

1. Për të rritur karakterin profesional të një programi Bachelor në Financë Kontabilitet brenda treguesit 20 % të ndryshimeve në program do të mund të shtoheshin lëndët karakterizuese si dhe numri i lëndëve me zgjedhje bazuar në gjetjet dhe sugjerimet të shprehura në këtë raport.



2. Për të siguruar një numër optimal studentësh në këtë program institucioni duhet të realizojë një marketing intensiv me studentët potencial të interesuar në këtë program studimi

Conclusions of the Evaluation of the First Cycle Bachelor Study Program in "Finance and Accounting" at "College University of Logos"

The External Evaluation Report was carried out under the conditions of full cooperation with the institution's structures and based on complete and transparent information in order to fulfill the objective of the evaluation of this program.

Strengths and affirmations

1. The program is offered by a qualified academic staff with long academic scientific experience in the country and abroad.
2. KUL guarantees the financial sustainability for the necessary financial support of the teaching and research process not only regarding to student fees but mainly from financial support in the form of donations from the LOGOS Foundation
3. The convenient location of the KUL building where the teaching process of this program takes place offers transportation and communication facilities for its students. Also, the afternoon lesson schedule is suitable for students who are in a working relationship.
4. The institution has the appropriate infrastructure for the effective development of the study program through the now renovated and contemporary laboratories as well as a physical and electronic fund rich in literature in the field of finance and accounting.
5. KUL and Faculty of Economy is active in cooperation agreements with foreign counterpart universities, mainly in Greece, enabling a satisfactory number of mobilities for the staff.

Weak points

1. The low number of students enrolled in this program jeopardizes the continuity of the program in the medium term future.
2. High competition from similar bachelor's programs offered by other public and private universities in the country


Recommendations

1. In order to increase the professional character of a Bachelor program on Finance and Accounting within the indicator of 20% of the changes in the program, the



characteristic subjects as well as the number of optional subjects should be added based on the findings and suggestions expressed in this report.

2. To ensure an optimal number of students in this program, the institution should carry out intensive marketing with potential students interested in this study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

